

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7777 E martë 29 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion *i* Ditës

Nga ADRI NURELLARI



Një ndër avancimet më të mëdha në shoqërinë shqiptare, kudo ku jeton, është konsolidimi e modernizimi i radiotelevizioneve private që mund të ...  
Vijon në faqen 20

**Pse duhet privatizuar radiotelevizioni shtetëror**

## Mesazhi *i* Ditës

Nga RAMUSH HARADINAJ



Pas marrjes së vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND-së) se shpallja e pavarësisë nga ana e Kosovës në vitin 2008 nuk ishte e paligjshme ...  
Vijon në faqen 21

**Kushtet e mia që Kosova të heqë "taksën" me Serbinë**



Elida Cani: Po përpëlitej në gjak

**Rrëfimi, i riu që vrau të dashurin e motrës: Më qeshi me ironi, ja si e godita me hekur**

Esat Cani: S' desha ta vrisja, por të vuante. 20-vjeçarja: Ai vinte kur vjehri flinte gjumë

TIRANË-Pak ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në fshatin Bastar i Mesëm në Tiranë, ku u vra me mjete të forta 34-vjeçari Arben Gjeci, Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës ka vendosur lënien në burg të autorit të krimit, Esat Cani. Sipas burimeve nga prokuroria, 31-vjeçari nuk ka toleruar lidhjen e viktimit me motrën e tij ...  
Në faqen 7

## AGJENCIA E PRONAVE PUBLIKON LISTEN E PERFITUESVE NGA FONDI I ALUZNIT

# EMRAT, 140 PRONARET QE NDAJNE 1.8 MILIONE USD

Kompensimi në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan. Dokumentet që duhen dorëzuar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave për të marrë paratë



(Në foto) Ndërtime në Tiranë

### ÇESHTJA NE HETIM

**Prokurori "ish-sigurims", Sula: I mitur u tërhoq në bashkëpunim**

Në faqen 3

### OPOZITA

**Basha nis turin nga Kavaja: Më 16 shkurt i japim fund këtij pushteti**

Në faqen 4

### STUDENTET

**Eksperti i arsimit: Protesta dështoi, qeveria më shumë. Të flasin pedagogët**

Në faqen 10-11

### EKSPOZITA

**Ismail Qemali, sendet që la pas arkitekti i Pavarësisë**

Në faqen 18-19

### LISTA E DYTE



**Zbardhen emrat e 2900 familjeve që do përfitojnë ndihmë ekonomike**

Në faqen 12-13

**Intevista/ Kryeministri hap ekspozitën në Gjermani e flet për "Deutsche Welle"**

## Kufijtë e Kosovës, Rama: Jemi pro SHBA-BE

*"Nuk shoh filxhan, por s' do plakem keq. Merkel s' më ka zhgënjyer"*

Edi Rama hapi në Berlin ekspozitën e tij të dytë personale brenda një kohe të shkurtër në Gjermani. Gjatë qëndrimit të tij në Gjermani ai dha dhe një intervistë për Radio DW, ku foli për pasionin e tij për pikturën dhe raportin e saj me politikën. Sa i përket çështjes së Kosovës,



ai deklaroi se do mbështesë çdo marrëveshje që mbështetet nga BE dhe SHBA. Artisti nga Kosova, Petrit Halilaj kur hyri në ekspozitë tha: "Është si të hysh në një hapësirë mendore, në kokën e Edit". E vërtetë? Isha shumë i kënaqur që erdhi Petriti. Ai është një ...

Në faqen 5

## DREJTËSIA AKUZAT

Alibeaj: KPK, vegël e pushtetit. A është takuar Donika Prela me Valbona Sanxhaktarin?

# PD: Prela pjesë e dosjes 339, del në përgjim me bandën 'Avdylaj'

"Prokurore me pasuri të pajustificuar"

Valentina Madani

Partia Demokratike dhe institucioni i prokurorisë janë përfshirë në një debat për shkak shëfës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda Donika Prela, të cilën demokratët e akuzojnë si të përfshirë në krim duke u gjendur në përgjimet e dosjes 339. Partia Demokratike u kërkon organeve të vetingut që ta detyrojnë Donika Prelën të përgjigjet, nëse ka urdhëruar e firmosur lirimin e kreut të bandës së Avdylajve dhe nxjerrjen e tij të pafajshëm në janar të 2018-ës, kohë kur Donika Prela drejtonte Prokurorinë e Durrësit. Sipas deputeti Enkelejd Alibeaj, rasti i drejtueses së Krimeve të Rënda po konfirmohet se KPK është një vegël në duart e pushtetit. "Në dosjen e Donika Prelës ka dokumente që provojnë se miliona lekë nga pasuria e saj janë të pajustificuar, se bashkëshorti i saj dyshohet për pastrim parash dhe se, në rastin më të mirë, ai ka punuar në të zezë. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit bëri një përpjekje të lavdërueshme për të hedhur dritë mbi aktivitetin e paligjshëm të Donika Prelës, por Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është urdhëruar të mbajë në sistem një tjetër prokurore të korruptuar, të shantazhueshme nga politika dhe nga bandit", deklaroi z. Alibeaj. Sipas tij, përpara se të japë vendimin për Donika Prelën, KPK duhet të verifikojë nga kamerat e sigurisë a është takuar Donika Prela në nëntor-dhjetor me anëtarin e vetingut Valbona Sanxhaktarin dhe a është pjesë e dosjes 339, duke u kapur në përgjim me Astrit Avdylajn. "Organet e vetingut duhet t'i japin përgjigje pyetjes: a është Donika Prela pjesë e dosjes 339, e kapur në përgjim me bandën e Avdylajve duke biseduar me kreun e bandës Astrit Avdylaj? Përgjimet e dosjes 339 janë bërë në kohën kur Donika Prela drejtonte Prokurorinë e Durrësit dhe Astrit Avdylaj u arrestua për armëmbajtje pa leje, por më pas u lirua si i pafajshëm", deklaroi z. Alibeaj. Për demokratët përgjimet e dosjes 339 janë bërë në kohën kur Donika Prela



Deputeti i PD-së Enkelejd Alibeaj

### AKUZA

"Organet e vetingut duhet t'i japin përgjigje pyetjes: a është Donika Prela pjesë e dosjes 339, e kapur në përgjim me bandën e Avdylajve duke biseduar me kreun e bandës Astrit Avdylaj? Përgjimet e dosjes 339 janë bërë në kohën kur Prela drejtonte Prokurorinë e Durrësit dhe Astrit Avdylaj u arrestua për armëmbajtje pa leje, por më pas u lirua si i pafajshëm", tha z. Alibeaj.

### PD: Prela cenoi sekretin hetimor

## Dosja 339, prokurorët e çështjes: Faktet janë të pavërteta

Dy prokurorët e dosjes "339" reagueshan nga Partia Demokratike, e cila me anë të deputeti Enkelejd Alibeaj, tha se Donika Prela është pjesë e përgjimeve me grupin Avdylaj. Prokurorët e çështjes e kanë quajtur jo të vërtetë akuzën, duke shkelur sekretin hetimor e duke gënjyer sipas Partisë Demokratike. Në një deklaratë për mediat prokurorët Vladimir Mara dhe Dritan Prençi, akuzat e PD-së janë të pavërteta. Duke e konsideruar pyetjen e shtruar nga Alibeaj, si fakt të servirur, prokurorët mohojnë e përfshirjen në përgjimet e dosjes 339 të Donika Prelës në komunikim me anëtarë të grupit Avdylaj. "Në lidhje me njoftimin publik të bërë të ditur nga konferencën për shtyp datë 28.01.2019 nga z. Enkelejd Alibeaj në selinë e PD-së,



se Drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda znj. Donika Prela rezultoi e përfshirë në përgjimet e dosjes Nr.339 në komunikim me anëtarë të grupit të Avdylaj, ju bëjmë me dije se faktet e deklaruar janë të pavërteta", shkruhet në deklaratën e prokurorëve Vladimir Mara dhe Dritan Prençi. Akti i paprecedent e quan PD këtë përgjigje të dy prokurorëve, të cilët sipas demokratëve nxorën sekretin hetimor në shkelje flagrante të ligjit, për të gënjyer

drejtonte Prokurorinë e Durrësit dhe Astrit Avdylaj u arrestua për armëmbajtje pa leje, por më pas u lirua si i pafajshëm", deklaroi z. Alibeaj. Për demokratët përgjimet e dosjes 339 janë bërë në kohën kur Donika Prela

përgjigjesinë të bëjë verifikim të plotë për Drejtuesen e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. "Një prokuror i korruptuar dhe me lidhje me krimin e organizuar nuk

er në favor të shëfës së tyre Prela. Faktet, sipas reagimit të PD-së, ndodhen pikërisht në dosjen 339. "Këtë e provojnë përgjimet e muajit janar 2018. Duke qenë se tani Donika Prela e ka çnuar sekretin hetimor, le t'i shkojë deri në fund", shprehet PD.

mund të japë drejtësi! Organet e vetingut kanë përgjigjesinë të mos lejojnë që një prokuror me pasuri të pajustificuar, e dyshuar për lidhje me krimin e or-

### Ambasada e SHBA-ve, thirrje prokurorëve: Aplikoni për SPAK

Ambasada e Shteteve të Bashkuara fton prokurorët të aplikojnë për të qenë anëtarë të SPAK. Në një postim në faqen zyrtare, Ambasada e SHBA-ve shprehet se Shqipëria po krijon një sistem të ri drejtësie, bazuar te pavarësia, profesionalizmi dhe integriteti. Ndaj dhe prokurorët, të cilët mishërojnë këto ideale i përgjigjen një thirrjeje për shërbim publik që është më e lartë sesa thjesht një vend pune. "Ne iu bëjmë thirrje këtyre njerëzve me kurajë që të bëhen pjesë e të ardhmes së Shqipërisë, duke aplikuar për të qenë anëtarë të SPAK" përfundon ambasada. Deri tani kanë aplikuar tre prokurorë për t'u bërë pjesë e strukturës së re të SPAK, përkatësisht Anton Martini, Besnik Muç dhe Klodian Braho. Në strukturën e SPAK do të jenë 15 prokurorë, ndërsa afati për dorëzimin e dokumenteve përfundon pas dy javësh.



ganizuar të drejtë strukturat më të rëndësishme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", u shpreh z. Alibeaj. Sipas demokratëve Drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda është në konflikt interesi pasi në muajt nëntor-dhjetor është takuar me një prej anëtarëve të këtij organi. "KPK të konfirmojë që Donika Prela, në konflikt të hapur interesi, është takuar gjatë periudhës që ishte nën veting me anëtarin e trupës së vetingut, Valbona Sanx-

haktari. I sugjerojmë të kërkojë kamerat e Sigurisë së Prokurorisë së Krimeve të Rënda në muajt nëntor-dhjetor", theksoi deputeti i PD-së. Opozita shprehet se rasti i Donika Prelës konfirmohet se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një vegël në duart e pushtetit për të mbajtur në sistem prokurorët dhe gjyqtarët të korruptuar. Demokratët e akuzojnë Prelën edhe për pasuri të pajustificuar ndërsa bashkëshortin e saj për pastrim parash.





## Sheshi: S'kam qenë bashkëpunëtor i Sigurimit, akuzat skenar mafioz

**L**vënë nën akuzë se ka fshehur të shkuarën e tij si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Bujar Sheshi ka mohuar dje që kjo të ishte e vërtetë, ndërsa foli për një skenar mafioz me prapavijë të qartë politike. Ai foli gjatë mbledhjes së djeshme të KLP-së, ku gjeti rastin të deklarohet edhe një herë prerë dhe qartazi se nuk ka qenë asnjëherë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. "Declaroju se nuk kam qenë asnjëherë bashkëpunëtor i fshehtë i Sigurimit të Shtetit. Objektivi i këtij sulmi më i ulet se kaq. Synohet të goditet procesi i reformës në drejtësi. Fakti që kanë arritur të manipulojnë deri në institucione shtetërore, me krijon bindjen që pas tij fshihen njerëz të rëndësishëm të politikës. Në rastin tim nuk synohet vetëm goditja ndaj meje për çështjet që kam hetuar, por synohet goditja si institucionin e KLP. Pasi kemi ardhur në një moment për krijimin e SPAK", - tha Bujar Sheshi. Më tej, ai shtoi se pas këtij veprimi fshihen segmente të caktuara, jo vetëm në njërin krah dhe persona me pushtet. "Përballë kësaj situatë do të kërkoja të gjithë përkrahjen tuaj për të zbardhur të vërtetën dhe zbardhur këtë skenar mafioz", - tha Sheshi.



## Theodhori Sollaku drejt Gjykatës Kushtetuese, synon vendin e Dedes

**I**sh-prokurori i Përgjithshëm, Theodhori Sollaku kërkoi të zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në vendin e lënë vakant nga Bashkim Dedja, që u shkarkua nga organet e vetingut. Kuvendi i Shqipërisë ka publikuar dje 3 kandidaturat që kanë aplikuar për pozicionin e mbetur bosh pas largimit të Dedes, ku rezultoi që të ketë aplikuar dhe Sollaku. Veç tij për këtë pozicion kanë shfaqur interes dhe dy kandidat të tjerë. Ata janë ish-drejtoresha e kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Marsida Xhaferllari dhe Avni Shehu. Të tri këto kandidatura janë dërguar KED për të bërë vlerësimin e tyre dhe renditjen që do t'i kthehet më pas Kuvendit për votim.

Arta Marku bëri përgjegjëse AIDSSH për situatën e krijuar me anëtarin e KLP-së

# "Sigurims", prokuroria nis hetimet për Bujar Sheshin dhe AIDSSH

Sheshi kishte deklaruar se nuk kishte qenë bashkëpunëtor

**P**rokuroria e Përgjithshme bëri të ditur dje nisjen hetimeve të thelluara për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Bujar Sheshi, i cili sipas Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, (AIDSSH) ka rezultuar si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit. Nëpërmjet një njoftimi të shpërndarë për mediat, Prokuroria e Përgjithshme ka bërë të ditur se deklarata zyrtare e bërë nga Bujar Sheshi gjatë momentit të aplikimit për anëtar KLP-je bie ndesh me vendimin e Autoritetit të Dosjeve, e cila e ka gjetur atë si bashkëpunëtor të Sigurimit të Shtetit në një moshë të mitur. Por sipas institucionit të prokurorisë, procedura e ndjekur prej saj është korrekte dhe se përgjegjëse për këtë situatë të krijuar është edhe AIDSSH, i cili sipas saj është përgjegjës përtej afateve ligjore që parashikon ligji. Sipas prokurorisë, megjithëse kërkesa për verifikim të figurës së Sheshit është dërguar që në tetor 2018, përgjigja ka ardhur vetëm në datë 23 janar 2019. "Vonesa në kthimin e përgjigjes nga AIDSSH dhe plotësimi i deklaratës individuale të nënshkruar prej prokurorit Bujar Sheshi, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk përputhet në përmbajtje me Vendimin e AIDSSH, janë objekt i një hetimi të thelluar nga prokuroria kompetente", - thuhet në deklaratën e Prokurorisë së Përgjithshme. Ndërkohë që prokuroria nëpërmjet kësaj deklarate ka bërë të ditur të gjitha hapat që janë ndjekur që nga aplikimi i Bujar Sheshit për anëtarë KLP-je në 12.10.2018, ku ndërmjet të tjerave ishte edhe deklarata e tij individuale, e nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, sipas të cilit, nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor apo i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit deri më datë 02 korrik 1991. Gjithsesi vetëm dy javë pas aplikimit, prokuroria bëri të ditur se është drejtuar AIDSSH-së, për të verifikuar kandidaturnën e prokurorit Bujar Sheshi, në ushtrim të funksioneve të tij, në zbatim të nenit 29, pika 1 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit". Organi qendror i akuzës



Mbledhja e djeshme e KLP-së

**ARGUMENTI**  
"Pasi është njohur me relacionin e Burimeve Njerëzore datë 01.11.2018, sipas të cilit prokurori Bujar Sheshi plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë kandidat i KLP, në kushtet kur verifikimi në AIDSSH nuk ishte një prej kriterëve të parashikuar në ligj, brenda afateve ligjore të detyrueshme, Prokurori i Përgjithshëm ka vijuar me procedurën për organizimin e Mbledhjes së Përgjithshme si hapi përfundimtar për ngritjen e KLP-së".

## Autoriteti Dosjeve: Sheshi u tërhoq në bashkëpunim i mitur

**A**utoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka konfirmuar dje akuzat e opozitës se gjatë verifikimit të figurës së pastërtisë, prokurori Bujar Sheshi ka rezultuar si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Nëpërmjet një deklarate të shpërndarë dje pasdite, AIDSSH thekson se për rastin në fjalë është dashur të bëhet një verifikim i thelluar nga ku ka rezultuar se Bujar Sheshi është tërhequr në bashkëpunim në një moshë të mitur. "Nga administrimi i dokumentacionit që disponojmë dhe nga verifikimet e kryera në fondet arkivore, të cilat përmbajnë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat ruhen në godina të ndryshme, shumë larg



nga zyrat aktuale të AIDSSH, u ndeshëm me ekzistencën e dokumenteve kontraktore për sa u takon të dhënave për shtetasin Bujar Sheshi, si dhe me faktin e njohjes me dokumentin e tërheqjes në bashkëpunim të shtetasit Bujar Sheshi në moshë të mitur (nën 18 vjeç)", - bën të ditur AIDSSH.

Nëpërmjet kësaj deklarate, AIDSSH i ka kthyer përgjigje edhe akuzave të ardhura nga politika, por edhe nga prokuroria për vonesë në kthimin e përgjigjes. Sipas këtij Autoriteti, verifikimi i thelluar morri kohën e vet dhe se përgjigja për kërkesën e prokurorisë është bërë në kohën më të shpejtë të mundshme. "U vlerësua të kryhet kërkimi i thelluar nga administrata, në fondet arkivore të disponueshme nga Autoriteti, për dokumentimin e aktivitetit përmes kërkimit në dosje dhe në procesverbale të asgjësimit dhe në listat e veçimit. Bëjmë me dije se ky kërkim i thelluar në fondet arkivore mori kohën e vet, sepse kërkimi është realizuar pothuajse në mënyrë manuale", - bëri të ditur AIDSSH.

AIDSSH nuk ishte një prej kriterëve të parashikuar në ligj, brenda afateve ligjore të detyrueshme, Prokurori i Përgjithshëm ka vijuar me procedurën për organizimin e Mbledhjes së Përgjithshme si hapi përfundimtar për ngritjen e KLP-së", bën të ditur më tej Prokuroria e Përgjithshme. Ndërkohë që dje me herët vetë Bujar Sheshi duke shfrytëzuar një mbledhje të

KLP-së deklaroi me forcë se nuk ka qenë asnjëherë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Ai akuzoi segmente të politikës, nga të dyja krahët, për atë që ai e quajti sajësë dhe "skenar tipikisht mafioz". Vet kreu i KLP-së, Genti Ibrahim i shpreh në fund të mbledhjes së djeshme se kjo çështje do ishte ditët në vijim objekt i vendimmarrjes së këtij institucioni.

## PROTESTAT TURI

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, nisi dje turin e takimeve në rrethe, duke mobilizuar të gjithë mbështetësit, për protestën e opozitës që pritet të mbahet më 16 shkurt në Tiranë. Gjatë një takimi që pati fillimisht me të rinjtë kavajas e më pas me qytetarët e Kavajës, Basha akuzoi kryeministrin Rama se ka marrë peng vendin dhe se falë ndjekjes së politikave të tij qeverisëse shqiptarët e kanë humbur besimin te politika shqiptare. Basha u shpreh se opozita po ngrihet për t'i dhënë fund një shteti të korruptuar dhe se me ardhjen në pushtet të PD, do të ndërtojë një kontratë të re sociale me qytetarët. Basha premtoi se gjëja e parë që do të bëjë me ardhjen e partisë së tij në pushtet është abrogimi i ligjit të arsimit të lartë, pasi sipas tij ky ligj ka dështuar dhe kjo punë do të fillojë me pedagogë e studentë për të ndërnuar një ligj me standarde europiane. Duke vënë theksin tek dyfishimi i buxhetit për arsimin e lartë, Basha prezantoi paketat mbështetëse për studentët, që sipas tij do të mundësojnë arsimin e të gjithë studentëve shqiptarë. "Dyfishimi i buxhetit për arsimin e lartë. Kjo do të thotë që gjithë studentët që vijnë nga familje me të ardhura nën 640 mijë lekë të vjetra në muaj përfitojnë jo përgjysmim, por financimin e plotë të tarifave universitare për bachelor dhe master. Do të thotë që me paratë e buxhetit të shtetit, që në fakt janë paratë e prindërve tuaj dhe me asnjë lek shtesë do bir dhe bijë shqiptari të ketë mundësinë të ndjekë studimet universitare në institucionet publike të arsimit të lartë pa paguar asnjë lekë nga tarifa universitare. Për ata që vijnë nga familje me të ardhura mbi 640 mijë lekë të vjetra, përgjysmim tarifash", deklaroi z.Basha.

### ANËTARËSIMI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, gjatë turit të dëgjesave prezantoi edhe programin e PD-së për anëtarësimin e vendit në BE. Ai njoftoi se PD ka gati 4 pika ku do të mbështesë programin e saj, të cilat do të bëjnë të mundur anëtarësimin e Shqipërisë në BE. "Hapi i parë është ndarja e politikës nga krimi. Prandaj atë që rrëzuan në dhjetor vetëingun e politikaneve atë do ta bëjmë realitet me mbështetjen tuaj, me votën e shqiptarëve të ndershëm. Pa çliuar parlamentin nga politikanët e lidhur me krimin, pa i dhënë fund një politike peng nga krimi, nuk hapen dyer e Europës", tha z.Basha. Së dyti - tha ai - garanti i garës së barabartë për administratën publike. "Është një

Kreu i PD nis turin e dëgjesave nga Kavaja: Dyfishojmë buxhetin e arsimit

# Basha: 4 hapat e opozitës për anëtarësimin në BE

"Më 16 shkurt do t'i japim fund shtetit grabitqar"



### PROTESTA

"T'i tregojmë Europës se Rama ka rënë dhe do largohet njëherë e më parë. Një popull që s'proteston, rrezikon të mbytet nga vesi. Koha kërkon një zgjim të madh të vetëdijes kombëtare", tha Basha.



Një nga protestat e opozitës

nga kërkesat kyç nga BE reforma në administratën publike. Europa është mbi të gjitha garë e ndershme. Rikthimi i garës së ndershme, rikthimi i barazisë para ligjit të çdo qytetari, ecja para në bazë të meritës është kushti ku pa të cilin nuk mund të shkohet drejt Europës dhe është objektivi madhor i imi dhe i PD, me garë të ndershme në politikë, në treg, në universitet, në zgjedhje", u shpreh z.Basha. Së treti - shtoi ai - është dekriminalizimi i zgjedhjeve. "Dekriminalizimi i zgjedhjeve do të thotë që në zgjedhjet e ardhshme shqiptarët të kenë mundësi të votojnë të lirë nga kërcënimet e bandave dhe nga paratë e drogës dhe korrupsionit, që të zgjedhur

drejtuesit që e meritojnë dhe këta drejtues të përgjigjen para jush për premtimet që kanë dhënë. Së fundmi, platforma jonë kundër oligarkisë. Nuk mjafton të çlirojmë ato para për arsimin e lartë pro duhet të çlirojmë edhe para për pensionistët, për fermerët, për uljen e taksave, për uljen e komoditeteve bazë të ekonomisë, të çmimit të energjisë dhe të naftës pa të cilat ekonomia jonë do të vazhdojë të mbetet jo konkurruese", tha Basha. Ai përmendi se: "Për t'i bërë të gjitha këto të mundura, ne do t'i japim fund praktikës korruptive të PPP-ve dhe bashkëpunimit me një grusht oligarkësh që deri më sot kanë marrë 2.2 miliardë euro kontrata nga ky shtet".

## Vendimi, PD grup pune për ligjin e arsimit me ish- ministra e pedagogë

Protestat e 16 shkurtit nuk do ta mbajë opozitën jashtë institucioneve. Të paktën deri në një vendim të dytë, demokratët do të vijojnë marrëdhënien e kushtëzuar me parlamentin. Në mbledhjen e djeshme me dyer të mbyllura të grupit kuendor, kreu i PD-së, Lulzim Basha u kërkoi deputetëve të jenë të pranishëm në ato komisione parlamentare ku do të ketë kalendar për çështje sensitivë që ka të bëjë me qytetarët, për të vijuar denoncimet ndaj qeverisë. Anulimi i ligjit për arsimin e lartë dhe buxheti janë edhe dy nga çështjet që i rikthyen në komisione deputetët e opozitës. Nga mbledhja e grupit, kreu i demokratëve kërkoi ngritjen e një grupi pune për ligjin e arsimit dhe njëherazi ftoi ish-ministra të Arsimit, deputetët e pedagogë që të kontribuojnë në hartimin e platformës për arsimin. Por krahas betejës në Kuvend, demokratët kanë nisur nga puna edhe për mobilizimin e strukturave për protestën e 16 Shkurtit. Ish-kryeministri Berisha është i bindur se stina e protestave do të sjellë rrëzimin e kryeministrit Rama.

Tirana International Airport  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

#### SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for supply with fuel for airside vehicles, fuel station, for a period of two year with possibility of renewal.

The company needs to have the respective license for fuel supply, and also be equipped with it's own tanker, that will deliver the fuel to Tirana International Airport fuel station.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com); [fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com) specifying, request for information for "Supply with Fuel for Airside Vehicles Fuel Station".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION FOR TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT'.

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Procurement Department  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 7 February 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all the following addresses:  
[apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)  
[fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com)  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)



Kreu i qeverisë ndodhet në Gjermani ku ka hapur ekspozitën e dytë personale

# Kufijtë e Kosovës, Edi Rama: Jemi pro marrëveshjes që mbështetet nga SHBA e BE

*"Unë nuk shikoj filxhan, por nuk po plakem keq si disa"*

**E**di Rama hapi në Berlin ekspozitën e tij të dytë personale brenda një kohe të shkurtër në Gjermani. Gjatë qëndrimit të tij në Gjermani ai dha dhe një intervistë për Radio DW, ku foli për pasionin e tij për pikturën dhe raportin e saj me politikën. Sa i përket çështjes së Kosovës, ai deklaroi se do mbështesë çdo marrëveshje që mbështetet nga BE dhe SHBA.

**Artisti nga Kosova Petrit Hallaj kur hyri në ekspozitë tha: Është si të hysh në një hapësirë mendore, në kërkim të Edit. E vërtetë?**

Isha shumë i kënaqur që erdhi Petriti. Ai është një superstar, është një djalë fantastik dhe ishte vërtet kënaqësi që ishte këtu dhe shprehu konsideratat e tij pozitive për këtë ekspozitë.



Kryeministri Edi Rama

**PIKTURA**  
"Unë thjesht gjatë kohës së punës vizatoj, vizatoj gjatë takimeve, vizatoj gjatë telefonatave, gjatë momenteve të pauzave dhe është një proces krejt i natyrshëm, ku dora ndjek njërin sy dhe njëri sy ndjek dorën, ndërkohë që vëmendja është e gjitha e përqendruar tek diskutimet, tek puna, tek vendimet për t'u marrë, tek çështjet për t'u adresuar"

## Grupi i PS rrëzon dekretet e Metës, argumentet s'qëndrojnë

**G**rupi parlamentar i Partisë Socialiste vendosi dje që të rrëzojë dy dekretet e Presidentit të Republikës, Ilir Meta me anë të të cilëve ai ktheu ligjin "Për Noterinë" dhe ligjin "Për Kadastrën". Ky vendim u mor në mbledhjen e grupit parlamentar të Partisë Socialiste të drejtuar nga Taulant Balla në mungesë të kryeministrit Edi Rama, i cili ndodhet në Gjermani. Sipas ligjvënësve socialistë, dy dekretet në fjalë do të rrëzohen pasi argumentet dhe pretendimet që ngre Kreu i Shtetit në relacionet shoqëruese për këtë dy nisma nuk qëndrojnë. Me Dekretin nr. 11054, datë 14.01.2019, Presidenti i Republikës vendosi kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", me qëllim rishqyrtimin e neneve 61, 65 dhe 76 të këtij ligji. Sipas Presidencës, përmbajtja e nenit 61 të ligjit "Për noterinë", nuk është i qartë dhe në harmoni me disa nene të tjera të këtij ligji. Gjithashtu, sipas presidentit në ligj nuk garantohet trajtimi i barabartë i noterëve përballë kostos që duhet të përballëjnë për sigurimin e veprimtarisë së tyre dhe nuk ofrohet siguri ligjore për mbrojtjen dhe mbështetjen e shtresave të pamunduara të shoqërisë. Po kështu pas ligjit "Për noterinë", Presidenti Meta nuk kaloi as ligjin "Për kadastrën". Kreu i Shtetit dekretoi kthimin në Kuvend të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", me qëllim rishqyrtimin e tij por pak ditë më pas kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame e quajti të paargumentuar kthimin nga presidenti. Lame deklaroi se në 14 faqe të Presidencës kundër ligjit nuk kishte asgjë dhe asnjë argument. Po kështu mësohet se ligjvënësit e PS kanë vendosur të rrëzojnë amendamentet e LSI-së për buxhetin. LSI kishte kërkuar në dhjetor që buxheti për arsimin të rritet në 5% të GDP.



**Ju pikturonim me bojëra uji mbi dokumente politike, a ka ndonjë lidhje midis përmbajtjes së letrave dhe asaj që pikturonim?**

Politika këtu nuk ka asnjë lidhje. Unë thjesht gjatë kohës së punës vizatoj, vizatoj gjatë takimeve, vizatoj gjatë telefonatave, gjatë momenteve të pauzave dhe është një proces krejt i natyrshëm, ku dora ndjek njërin sy dhe njëri sy ndjek dorën, ndërkohë që vëmendja është e gjitha e përqendruar tek diskutimet, tek puna, tek vendimet për t'u marrë, tek çështjet për t'u adresuar.

**Pra, nuk keni parë ndonjë bashkëvarësi, ndonjë ndryshim, ta zëmë, mes pikturës mbi një letër që e keni bërë për kancelaren Angela Merkel dhe një letër për presidentin Ilir Meta?**

Jo, nuk e kam parë këtë gjë.

**Në një intervistë për shtypin gjerman ju kisht thënë se hytë në politikë, në fillim të viteve 1990, për shkak të një detyrimi qytetar, se të qenit artist nuk ju çlironte nga kjo përgjegjësi. Tani jeni politikan dhe vazhdoni të merreni me art. Është një vendim ky i vetëdijshëm, i marrë me intuitë, apo një strategji "exit"?**

Unë e kam organike, e kam njësoj si ajrin që thith. Faktikisht nuk më pengon, përkundrazi, më ndihmon. Sepse ndërkohë puna ime vazhdon normalisht, edhe kjo pjesa tjetër vazhdon

normalisht. **Kur vini në Gjermani media ju etiketon si simpatizant të kancelares Merkel. A mo jeni i zhgënjyer paksa nga politika e saj ndaj Ballkanit?**

Absolutisht nuk kam asnjë arsye që të zhgënjehem. Ajo është një mike e vërtetë e popujve të të gjithë rajonit tonë, është një lider vizionar dhe jashtëzakonisht e qartë për të ardhmen. Mbi të gjitha është një shembull fantastik lidhshipi dhe një pishartmbajtëse e vendosur e idesë sonë.

**Pyes, sepse është krijuar përshtypja se kohët e fundit ju po afroheni më shumë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat aktualisht po bëjnë edhe presion të madh për çështjen e Kosovës.**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë të angazhuara dhe mbështetëse të Kosovës qysh në ditën një dhe pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës Kosova nuk do të ishte çliruar dot nga kthe-tratrat e Beogradit dhe nuk do të ishte dot shteti i pavarur që është sot. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë qysh në ditën një mbështetëse të palëkundura të zhvillimit të demokracisë në Shqipëri dhe qysh në ditën një Shqipëria ka qenë qartësisht e shprehur për partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht se kush ka qenë në qeveri, e majta dhe e djathta.

**Çfarë prisni ju nga qeveria gjermane konkretisht në muajt e ardhshëm?**

Nuk pres asgjë të veçantë, sepse qeveria gjermane gjithnjë ka bërë gjërat e duhura në botë dhe në rajon. Është një qeveri shumë serioze e një vendi shumë serioz e një shteti realist mik që ka qenë jashtëzakonisht shumë e pranishme në Shqipëri mes programeve të mbështetjes dhe që investon jashtëzakonisht shumë për demokratizimin e rajonit dhe për integrimin evropian të rajonit, përfshirë edhe Shqipërinë.

**Gjermania është kundër ndryshimit të kufijve si zgjidhje mes Serbisë dhe Kosovës. Një argument është se kjo zgjidhje e dialogut Serbi-Kosovë do ta vononte hyrjen e vendeve të rajonit në BE. A pajtoheni me këtë argument?**

Në këndvështrimin tim ka një proces të domosdoshëm dialogu, i cili duhet të finalizohet dhe padyshim që duhet të finalizohet në një marrëveshje historike mes Serbisë dhe Kosovës. Për sa na takon neve, ne mbështesim çdo marrëveshje që ka pa ekuivok mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe BE-së. Kaq. Të tjerat pastaj janë "dokorra hini", siç thoshte At Gjergj Fishta.

**Edi Rama pikturon mbi dokumente dhe letra që zakonisht i përdor si politikan. Këtu ka një letër drejtuar Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta ku reagon ndaj refuzimit që i bëri kreu i shtetit emërimin të Sandër Lleshajt si ministër i Brendshëm. Një marrëveshje që u arrit në Ballkan ishte ajo e Prespës,**

**e cila u kurorëzua të premtën me votën që i dha parlamenti grek. Si e shikoni ju të ardhmen e shqiptarëve në kuadër të Maqedonisë së Veriut?**

Besoj që ka qenë një hap absolutisht i rëndësishëm historik. Është dashur një periudhë e stërgjatë kohe bllokimi, konflikti, pengesash, por edhe një lidhship kurajoz për të realizuar një marrëveshje që çliron përfundimisht një ngërç të madh në rajonin dhe u hap perspektivë të gjithë popujve të përfshirë në këtë proces, qoftë maqedonasve, qoftë shqiptarëve.

**Një pyetje për politikën e brendshme. Opozita është bashkuar dhe ka paralajmëruar protesta për t'ju rrëzuar nga pushteti. A ju frikësojnë këto kërcënime?**

Unë nuk flas për politikën e brendshme asnjëherë kur jam jashtë vendit.

**Ku e shikoni veten në të ardhmen, kur të mos jeni më kryeministër i Shqipërisë? Si artist apo si ndërprerësues ndërkomëtar?**

Unë nuk shikoj filxhan. E bukura e kësaj jete asnjëherë nuk planifikohet. Thjesht mund të ëndërrohet. Për sa i përket mënyrës si e ëndërroj, kjo është shumë intime për ta ndarë me ju. Por them që nuk do plakem keq, si ca që nuk ikin dot nga politika dhe që lemerisin kalamajtë e këmbëngulin për të qenë pjesë, ndërkohë që mund të bënin diçka shumë më fisnike në periudhën e fundit aktive të jetës.

Ish-ministri: Zvarritja e qëllimtë, për të vonuar dhënien e drejtësisë

TIRANË

# Tahiri ankimon në gjykatë shtyrjen me 3 muaj të afateve të hetimeve

*"Vendimi i prokurorisë, i pabazuar në ligj dhe prova"*



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri ka ankiuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda zgjatjen e hetimeve ndaj tij me 3 muaj të tjerë. Vendimi për zgjatjen e hetimeve iu komunikua disa ditë më parë, ndërkohë që ai kërkon që çështja të shkojë në gjykatë, në mënyrë që të jepet vendikimi final i drejtësisë. Sipas tij, vendimi për shtyrjen e hetimeve është i pabazuar në ligj dhe në prova. Pas skadimit të afateve për përfundimin e hetimeve ndaj Tahirit dhe konkretisht më 17 janar të këtij viti, Prokuroria e Krimeve të Rënda vendosi të zgjasë hetimet me tre muaj të tjerë. Shkak për shtyrjen e hetimeve, sipas prokurorisë vjen për disa veprime të tjera hetimore. Prokuroria deklaroi se pritet përgjigja për ndihmë juridike nga Mali i Zi dhe përkthimi i akteve të marra nga Italia. Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" sigurojë letër-ankimimin e ish-ministrit në të cilën shkruhet se në zgjatjen 5 herë të afatit të hetimeve, prokuroria nuk ka marrë në konsideratë katër pikat të rëndësishme.

**ANKIMIMI I TAHIRIT**

Në letër-ankimin thuhet: "Nga zgjatja me 5 herë e afatit të hetimit, konkludojmë se prokuroria nuk ka asnjë konsideratë as për; a) rëndësinë dhe vlerën provuese të përgjigjeve që pret prej letërporosive, b) lidhjen e këtyre përgjigjeve me ndonjë fakt

penal, c) mundësinë që këto përgjigje të ishin marrë më përpara qoftë nëpërmjet letërporosive qoftë nëpërmjet veprimeve të tjera hetimore dhe d) mundësinë që këto prova e përgjigje të merren në një afat më të shkurtër se sa afati 3-mujor i kërkuar nga prokuroria për zgjatjen e hetimeve". "Sa më

sipër, dëshmon se zgjatja e afatit nga ana e organit të akuzës për të 5-tën herë, bëhet vetëm me qëllim për të zvarritur hetimet dhe për të vonuar dhënien e drejtësisë", citohe më tej në ankimin e ish-ministrit Tahiri. Hetimet ndaj ish-ministrit të Brendshëm nisën në tetor të vitit 2017, ndërsa

**VENDIMI I PROKURORËVE**

Në vendimin për shtyrjen e hetimeve tre prokurorët Vladimir Mara, Dritan Prenci dhe Arens Çela arsyetojnë se më datë 10.12.2018 u është dërguar kërkesa për ndihmë juridike autoriteteve të drejtësisë të Malit të Zi (në vijim të letërporosive të tjera) dhe akoma nuk janë administruar aktet në ekzekutim të kësaj letërporosie. Po ashtu, në vijim të kërkesave për ndihmë juridike, më datë 04.01.2019 janë administruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë aktet në ekzekutim të letërporosisë dërguar autoriteteve italiane të drejtësisë më datë 31.12.2018. Këto akte aktualisht po përkthehen në gjuhën shqipe.

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka zgatur disa herë afat e hetimit, pasi nuk ka mundur të sigurojë të gjitha provat që implikojnë Tahirin në trafikun e drogës me Habilajt. Më 12 maj, gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda caktoi masën e sigurisë "Arrest shtëpie" për Tahiri, vendim i cili u prish nga Gjykata e Apelit dy javë më vonë. Aktualisht Saimir Tahiri po hetohet në gjendje të lirë. Ish-ministri i Brendshëm akuzohet se ka bashkëpunuar me grupin e Habilajve për trafikim të lëndëve narkotike dhe shpërdorim detyrë. Pavarësisht akuzave, Tahiri gjithmonë i ka mohuar ato. Ndërsa prokuroria e Katanias pak muaj më parë vendosi pushimin e hetimeve, pasi nuk gjeti prova për përfshirjen e Tahirit në trafikun e drogës.

**Legalizuan një ndërtesë pa leje në pronën e dikujt tjetër**

**Abuzimi me detyrën, pezullohen me urdhër të prokurorisë 5 zyrtarë të ALUIZNI-t në Vlorë**

**VLORE** - Pesë zyrtarë të ALUIZNI-t në Vlorë janë pezulluar nga detyra, pasi akuzohen për "shpërdorim detyrë". Bëhet fjalë për shtetasit: Denis Metaj, Artan Beqiri, Erald Zeiri, Danjela Kondaj dhe Xhilda Korrkaj. Burimeve nga prokuroria e qytetit bregdetar dhe bëjnë me dije se ata akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë legalizuar në bashkëpunim me njëri-tjetrin një ndërtesë pa leje në pronën e familjes Myzejen Zyrrkaj. Ndërkaq, mësohet se nën hetim është e gjithë Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë si dhe personi që ka legalizuar në pronën e një trashëgimtareje, Melsi Mustafaj. "Prokuroria Vlorë regjistroi procedimin penal të paraqitur nga shtetasi Myzejen Zyrrkaj, për veprën penale "Shpërdorim detyrë", i parashikuar nge neni 248 i K.Penal, ndaj shtetasit Melsi Mustafaj dhe Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Vlorë". Sipas prokurorisë, kallëzuesja është një nga trashëgimtarët ligjorë të babait të saj shtetasit Sinan Jaupi Ferhati. Me vendimin nr.77, datë 15.04.1995, KKKP, Bashkia Vlorë njohu tru-

- ZYRTARËT E PEZULLUAR NGA DETYRA**
- 1.Denis Metaj
  - 2.Artan Beqiri
  - 3.Erald Zeiri
  - 4.Danjela Kondaj
  - 5.Xhilda Korrkaj

allin në lagjen "Skelë", me sipërfaqe 4200m<sup>2</sup>, thuhet në njoftimin e organit të akuzës. Ndërkaq, sqarohet se ky vendim është regjistruar në ZVRPP-Vlorë. Kallëzuesja sqaron se prona është regjistruar në datë 18.03.1996 dhe është marrë vërtetim hipotekë në emër të babait. Në 2001, 2006 dhe 2008, është marrë certifikata e pronësisë për pasurinë me sipërfaqe 490m<sup>2</sup>. Kallëzuesja shpjegon se, lidhur me këtë pronë ka pasur një kalvar të gjatë gjyqesh dhe duke përfutur nga ky fakt si dhe zvarritjeve të çështjeve gjyqësore, mbi këtë truall janë ngritur ndërtime pa leje. Mbi truallin 490m<sup>2</sup> është kryer ndërtim pa

leje nga shtetasi Melsi Mustafaj, i cili u padit nga Enver Ferhati, djali i shtetasit Sinan Jaupi Ferhati, drejtuar Gjykatës Vlorë me objekt "Lirim dorëzim sendi", sipërfaqes truall 490m<sup>2</sup>. Në 30.10.2008 Gjykata Vlorë pranoi padinë sipas objektit të saj. Për këtë vendim është lëshuar urdhri i ekzekutimit dhe kjo dosje është depozituar pranë Shërbimit Përmbarimor Vlorë. Zyra Përmbarimore Vlorë tha se dosja me vendimin dt. 30.10.2018 dhe urdhri i ekzekutimit nuk ndodhej pranë këtij institucioni. Urdhrat e ekzekutimit nuk janë ekzekutuar, referuar shkrësave 12.03.2014, datë 29.10.2014 dhe 30.12.2015. Kallëzuesja iu drejtua IKMT-së, Tiranë, për zbatimin e vendimit gjyqësor dhe IKMT e vë në dijeni se objekti i ndërtuar pa leje nga shtetasi Melsi Mustafaj, është në proces legalizimi, pranë ALUIZNI-t Vlorë. ALUIZNI Vlorë informon se objekti informal i shtetasit Melsi Mustafaj është në proces legalizimi por sipas saj ALUIZNI-t Vlorë në kundërshtim me ligjin nr.9432, datë 03.04.2006 "Për legalizimin e ndërtimeve informale", ka pajisur shteta-



Prokuroria Vlorë

sin Melsi Mustafaj me lejen e legalizimit. Dosja e legalizimit i përmban të gjithë dokumentacionin ligjor, konkretisht matjet dhe verifikimet në terren lidhur me ndërtimin informal. Nga sa më lart, duke analizuar provat në tërësi dhe në harmoni me parashikimet ligjore arrihet në përfundimin se ndodhemi para elementëve të veprës penale "Shpërdorim detyrë", veprë e parashikuar nga neni 248 të K.Penal. Veprimet apo mosveprimet e kryera nga punonjësit e Drejtorisë ALUIZNI-t Vlorë në këtë rast, lidhur me kualifikimin dhe legalizimin e objektit informal të shtetasit Melsi Mustafaj, lagjja "Pavarësia", Vlorë, përmbushin elementët e veprës penale "Shpërdorim detyrë", të parashikuar nga neni 248 të K.Penal. Veprimet apo mosveprimet e kryera nga ALUIZNI Vlorë lidhur me legalizimin e ndërtimit in-

formal të shtetasit Melsi Mustafaj, janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr.62/2015, "Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Nderimeve pa Leje", si dhe akte nënligjore, të cilat përcaktojnë rastet e kualifikimit dhe ndalesat ligjore lidhur me legalizimin e ndërtimit informal. Nga veprimet e kryera nga punonjësit e ALUIZNI-t Vlorë, në këtë rast është cenuar e drejta e pronësisë lidhur me pronën nr.12/356, vol.15, fq.10, ZK.8602, sip.490m<sup>2</sup>, në emër B.P.F, duke legalizuar jashtë kriterieve ligjore, si dhe duke i dhënë të drejtën e pronësisë në ndërtim informal, konkretisht objektit të shtetasit Melsi Mustafaj. Prona në B.P.F është pronë e vjetër, regjistruar mbi bazën e dokumentit ligjor më 15.04.1995, KKKP, Bashkia Vlorë.

**SHKURT**

**Grabiti bankën me kallashnikov, identifikohet autori i maskuar**

**TEPELENË** - Një bankë e nivelit të dytë në Tepelenë është grabitur pasditen e djeshme nga një person i maskuar dhe i armatosur me kallashnikov. Dëshmitarët kanë deklaruar në polici se agresori që dyshohet të jetë 35 vjeç ka qenë i veshur me rroba ushtarake. Nën kërcënimin e armës, ai ka grabitur paratë e xhiros ditore që ndodheshin në arkë dhe më pas është larguar me shpejtësi. Mësohet se punonjësit e bankës kanë mbetur të tronditur dhe nuk kanë dhënë asnjë sinjal alarmi për të lajmëruar policinë në kohë. Pas marrjes së informacionit, blutë kanë ngritur postblloqe përgjatë gjithë akseve Tepelenë-Kakavijë dhe Tepelenë-Tiranë si dhe në drejtim të fshatit Salari nga mendohet se mund të jetë drejtuar grabitësi. Vetëm pak orë pas ngjarjes, burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se është bërë e mundur identifikimi i autorit të grabitjes së bankës. Gjithashtu, policia deklaroi se për arsyë hetimi nuk bëhen me dije generalitetet e autorit, ndërsa po punohet duke përdorur të gjitha format e metodat operacionale dhe hetimore për të bërë të mundur kapjen e tij.

**Aksidenti për vdekje 20-vjeçarit dhe e la në rrugë, kapet i riu**

**FIER** - Policia e Fierit ka vënë dje në pranga autorin e aksidentit që i mori jetën 20-vjeçarit Arif Xhahja nga fshati Hoxharë e Vjetër. Pas një pune hetimore intensive nga Specialistët e Qarkullimit Rrugor dhe Specialistët për Hetimin e Krimeve, u bë i mundur kapja dhe ndalimi i shtetasit A.B, 24 vjeç, banues në Pojan. Sipas policisë, shtetasi A.B, duke drejtuar automjetin tip "Volksvagen" në aksin rrugor Fier-Dërmënas, dyshohet se ka aksidentuar shtetasin A.Xh. dhe më pas është larguar nga vendngjarja. 20-vjeçari u gjet mbrëmjen e së dielës pa jetë në një kanal në fshatin Hoxharë e Vjetër të njesisë Dërmënas në Fier nga familjarët dhe është transportuar për në spital nga i ati. Materialet do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprime të mëtejshme procedurale.

Vrasësi Esat Cani: S'desha ta vrisja të dashurin e motrës, e godita që të vuante ca kohë

# "Me Arbenin kishim disa muaj të lidhur, ai vinte në shtëpi kur vjehri dhe vjehrra ishin në gjumë"

## Elida Cani: Ai po përpëlitej mes një pellgu gjaku. Bashkëshorti më tha të fshihja gjurmët, jam penduar

TIRANË

Pak ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në fshatin Bastar i Mesëm në Tiranë, ku u vra me mjete të forta 34-vjeçari Arben Gjeci, Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës ka vendosur lënien në burg të autorit të krimit, Esat Cani. Sipas burimeve nga prokuroria, 31-vjeçari nuk ka toleruar lidhjen e viktimës me motrën e tij, duke e masakruar me një levë hekuri. Ndërkaq, togat e zeza të kryeqytetit kanë vendosur masën e sigurisë "Arrest shtëpie" ndaj 20-vjeçares Elida Cani, e cila që prej disa muajsh ishte në një lidhje jashtëmartesore me viktimën, baba i tre fëmijëve. Gjithashtu, gjykata ka vendosur masën e sigurisë "Arrest shtëpie" dhe për 29-vjeçarin Dëfrim Kurti, bashkëshort i së resë, që u bë shkas për këtë ngjarje që tronditi banorët e zonës. Pas hetimeve të kryera dhe marrjes në pyetje të personave të përfshirë në këtë krim, prokuroria ka zbardhur kronologjinë e vrasjes së Arben Gjecit. Mësohet se Esat Cani, vëllai i shtetas Elida Cani, ka deklaruar se ka qenë ai, që e ka vranë shoferin e furgonit të kësaj zone, duke e goditur me hekur në kokë. "E godita, jo për ta vranë, por që të vuante ca kohë dhe të mos të shkatërronte më tej martesën e motrës. E ruajta gjithë ditën Arbenin. E pashë furgonin e tij kur parkoi në lokal dhe pui kafë me kunatin tim, burrin e Elidës, pastaj të dy u larguan. Kunati iku në një lokal tjetër, ndërsa Arbeni u drejtua drejt shtëpisë së motrës. Arbenin e qëllova tri herë me levë pas koke dhe më pas u largova në shtëpi", ka thënë para hetuesve të çështjes, autori i vrasjes. Ndërkohë që motra e tij, Elida ka pranuar lidhjen me viktimën dhe është shprehur e penduar për gjithçka që ndodhi. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë dosjen e prokurorisë në lidhje me këtë ngjarje.

**DËSHMIA E ELIDA CANIT**

Fillimisht 20-vjeçarja nuk ka pranuar lidhjen jashtëmartesore me 34-vjeçarin, por më pas ajo ka treguar me detaje se si është lidhur me babain e 3 fëmijëve. "Nuk e pranova më herët se kisha lidhje me Arben Gjecin, pasi kisha frikë. Tani nuk kam se çfarë fshih më. Kam pasur lidhje të fshehtë me Arbenin, që ka filluar disa muaj më parë. Atë natë e kishim lënë për t'u takuar. Burri nuk ishte në shtëpi, pasi ndodhej në lokal, ndërsa vjehrrin dhe vjehrrën i kishitë zënë gjumi. Doja ta anulova takimin, por Arbeni nuk pranoi dhe më kërkoi që të takoheshim. Vendi ku takoheshim në të dy ishte një dhomë e veçuar nga shtëpia (shtëpia e burrit të saj). Pata merak se mos vinte burri, por ai më tha të rrija e qetë, sepse



Autori i vrasjes, Esat Cani



20-vjeçarja, Elida Cani



Dëfrim Kurti dhe bashkëshortja e tij, Elida Cani

burri po pinte kafë. Kryem marrëdhënie dhe kur po vishje, më tregoi se kishte qenë i frikësuar gjithë ditën, pasi kishte pasur idenë që po e ndiqte dikush. Nuk pashë kush e qëlloi, por kur dola, pashë atë të përpëlitej në mes

të pellgut me gjak. Mua më tha burri të fshija njollat e gjakut dhe unë i fshiva... jam penduar".

**DËSHMIA E AUTORIT ESAT CANI**

31-vjeçari Esat Cani gjatë dëshmisë së tij është shpre-

**AKUZAT**

Pas arrestimit, burime nga policia e Tiranës bënë me dije se 31-vjeçari Esat Cani akuzohet për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen". Ndërkohë, po të njëjtat burime pohuan se bashkëshortët Dëfrim Kurti dhe Elida Cani (motra e vrasësit) akuzohen për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Gjithashtu, Kurti akuzohet dhe "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike".

hur se dyshonte që Arben Gjeci ngacmonte ose nusen, ose motrën e tij, ndaj dhe kishte disa ditë që e ruante. "Kur u ktheva nga Greqia, ishim si pasagjerë në makinën që drejtonte Arbeni. Bashkë me mua ishte motra ime dhe e fejuara. Arbeni po sillte çuditshëm dhe unë aty dyshova se ai ishte lidhur ose me motrën time, ose me të fejuarën. Ditën e ngjarjes dola nga banesa dhe i thash

babait se po iki në punë, kur po kaloja tek lokali pasë furgonin, por jo atë. Aty dyshova... shkova në shtëpi, mora një shufër hekuri dhe ika tek shtëpia e motrës dhe qëndrova pas kashtores. Nga ai pozicion pashë tek dera ku depërtonte drita një lëvizje dhe pasi u hap dera, doli Arbeni. Ai më pa dhe filloi të qeshte me ironi. Unë e godita me hekur pas koke, dy a tri herë dhe ika

**MASA E SIGURISË**

Gjykata e Tiranës dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Esat Canit, i cili mbërmjen e së enjtes masakroi me levë hekuri 34-vjeçarin Arben Gjeci. Ndërkaq, togat e zeza të kryeqytetit vendosën masën e sigurisë "Arrest shtëpie" ndaj 20-vjeçares Elida Cani (motrën e autorit të krimit) dhe bashkëshortit të saj 29-vjeçar, Dëfrim Kurti.

qetësisht në shtëpi. Nuk doja ta vrisja, por ta rriha që të vuante ca kohë", është shprehur ndër të tjera autori i ngjarjes.

**DËSHMIA E DËFRIM KURTIT**

"Më telefonoi Elida duke qarë dhe më tha hajde shpejt se kemi një burrë të gjakosur në shtëpi, dikush ka qëlluar Arben Gjecin. Pastaj më tha me mua ç'të duash, ai ishte tek unë... Kur shkova në shtëpi e pyeta nëse dinte gjë mami dhe babi dhe për shkak të fjalëve që mund të hapeshin në fshat, vendosëm që të tregonim shënimin që Arbeni ishte plagosur në rrugë dhe e nxorëm trupin jashtë banese".

**REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES**

**Subject:** Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers>) or UN Albania website (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement>) to download the detailed RFPS document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked:

**"LRPS-2019-9146183 - Provision of the communication, public relations, event organization and coordination services to promote the child and family - friendly Wi-Fi in public spaces in Tirana and beyond."** to the following address:

**United Nations Children's Fund (UNICEF)**  
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania  
Tel. +355 44548400; Website: www.unicef.org/albania

**Relevant Dates:** All interested companies must submit their application, not later than **06 February 2019, 16:00 hrs.**

**Vrasja e studentit Marvi Mihali, gjykata pranon të administrojë si provë pamjet filmike**

**TIRANË** - Gjykata e Tiranës ka vendosur të administrojë si provë pamjet filmike të vrasjes në mënyrë makabre të Marvi Mihalit. Kërkesa për marrjen e kësaj prove ishte paraqitur nga prokuroria, megjithatë avokatët kundërshtuan ashpër marrjen e kësaj prove, me argumentin se nuk ndryshon asgjë në proces. Kjo solli reagimin e ashpër në sallën e gjyqit të prindërve të viktimës. Gjatë seancës, avokati Agron Gurabardhi tha se do të dorëzojë dy vëllezërit Marsel dhe Kridens Alla, të cilët janë në arrati, me qëllim që të japin versionin e tyre për ngjarjen. "Unë si avokat kam kërkuar që ata të vijnë këtu. Pastaj ata do vendosin nëse duhet të vijnë apo jo. Unë u kam kërkuar që të vijnë, sepse jam i bindur në pafajësinë e tyre për këtë akuzë", tha avokati Gurabardhi. Në seancën e radhës pritet që të japin dëshmitë e tyre edhe dëshmitarët e thirrur nga gjykata. Marvi Mihali u godit me thikë korrikun e vitit 2017 dhe ndërroi jetë për shkak të plagëve të marra pas një konflikti për një karikues telefoni mes një mikut të tij dhe Dejvi Bitrajt.

**Financat publikojnë të dhënat zyrtare**

**Buxheti 2018, 100 mln euro të ardhura më pak**

**TE ARDHURAT**

Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave tregojnë se të ardhurat totale në arkën e shtetit për gjithë vitin 2018 rezultuan 449.3 miliardë lekë nga 461.8 miliardë, që ishin parashikuar në aktin normativ të qeverisë. Sipas statistikave të detajuara, gjysma e mosrealizimeve ishte nga të ardhurat jostatimore dhe ndihmat, ndërsa gjysma tjetër ka ardhur si pasojë e ecurisë së dobët në mbledhjen e akcizave dhe tatimit mbi vlerën e shtuar.



Buxheti i shtetit nuk ka mundur të realizojë planin gjatë vitit të shkuar. Në arkën e shtetit mungojnë 100 milionë euro të ardhura në raport me planin. Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave tregojnë se të ardhurat totale në arkën e shtetit për gjithë vitin 2018 rezultuan 449.3 miliardë lekë nga 461.8 miliardë, që ishin parashikuar në aktin normativ të qeverisë. Sipas statistikave të detajuara, gjysma e mosrealizimeve ishte nga të ardhurat jostatimore dhe ndihmat, ndërsa gjysma tjetër ka ardhur si pasojë e ecurisë së dobët në mbledhjen e akcizave dhe tatimit mbi vlerën e shtuar. Të dy këto taksa qenë 7.4 miliardë lekë ose rreth 60 mil-

ionë euro më pak se plani vjetor të ndikuara kryesisht nga rënia e euros ndaj lekut, por edhe ulja e papritur në zhodoganimin e cigareve. Në

krahun tjetër të buxhetit, atë të shpenzimeve, mosrealizimet kanë qenë edhe më të mëdha se sa tek të ardhurat. Sipas të dhënave nga Finan-

cat, shpenzimet faktike të buxhetit ishin gati 147 milionë euro më të ulëta se plani. Për shkak se mosrealizimi i shpenzimeve ka qenë më i

madh se sa ai i të ardhurave, qeveria ka marrë më pak borxh nga kufiri i caktuar me ligj. Deficiti buxhetor për vitin e kaluar rezultoi 47 mil-

ionë euro më pak se plani, duke sinjalizuar se borxhi publik në raport me prodhimin kombëtar është ulur edhe më shumë nga sa pritej.

Nëse e aplikojnë, gjobë 10% të xhiros për Urdhrin, 5 mln lekë për individët

**Shërbimet dentare, Konkurrenca pezullon vendimin e Asamblesë Kombëtare**

*Autoriteti i Konkurrencës nis hetimin për tregun e shërbimeve stomatologjike*

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Vendimit të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, "Për miratimin e listës së çmimeve dysHEME për shërbimin stomatologjik", pasi bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Në rast se ky vendim nuk do të zbatohet, atëherë Urdhri i Stomatologut do të ndëshkohet me gjobë deri në 10% të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës. Po ashtu, edhe individët që do të zbatojnë këtë vendim, gjobiten në masën deri 5 milionë lekë.

**VENDIMI**

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur në mbledhjen e fundit të hapë procedurën e hetimit para-prak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrëmbërimit të dispozitave të ligjit për konkurrencën. Kjo masë u mor pasi Autoriteti i Konkurrencës u njoh përmas medias lidhur me një Vendim të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut "Për miratimin e listës së çmimeve dysHEME për shërbimin stomatologjik" sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysHEME për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: terapinë, ortopedinë, kirurgjinë dhe ortodoncinë. Konkurrenca thekson se në bazë të ligjit për konkurrencën janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrëmbërimin e konkurrencës në treg. Ajo shton se vendimi i mësipërm i Urdhrit të Stomatologut mund të ketë element të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003. Sipas raportit të konkurrencës, Misioni i Urdhrit të Stomatologëve është të ruajta e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimit e profesionit të stoma-



Foto ilustruese

tologut dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i këtij profesioni. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jo buxhetor, i cili përfaqëson interesat e

përbashkëta të profesionistëve, stomatologëve dhe ndihmësstomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut - thuhet në njoftim. Prej fillimit të 2019-ës, klini-

kat dentare në vend janë të detyruara që të bazohen në listën e re me çmimet dysHEME për shërbimet bazë që ofrojnë, të caktuara në një shkresë të Urdhrit të Stomatologëve. Për një mbushje dhëmbi të gradës së dytë, përpara 1 janarit pacientët duhet të paguanin 2,000 lekë, ndërsa tani me çmimin dysHEME që ka vendosur Urdhri i Stomatologut, pacientët duhet të paguajnë 4,000 lekë, ose dyfish. Rritje ka pasur edhe për shërbimet e tjera dentare. Pjesa më e madhe e klinikave në vend për vizitat e pacientët (ekzaminim me sy) i kanë falas, por prej 1 janarit për vizitat çmimi dysHEME është 500 lekë. Për mbushjet e gradës së tretë, çmimi ishte 3,000 lekë, ndërsa me referencën e re çmimi bëhet 5,000 lekë (2,000 lekë më shumë, shtrenjtim 67%).

**Koncesionet/PPP, Ahmetaj: Do të vazhdojnë të përdoren nga qeveria**

Pas akuzave të Partisë Demokratike se qeveria ka shkelur direktivat europiane lidhur me koncesionet dhe Partneriteti Publik Privat, ka reaguar edhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Sipas tij, qeveria ka bërë kufizimet e nevojshme në ligj dhe koncesionet/PPP do të vazhdojnë të përdoren nga qeveria. "PPP është një instrument që do të vazhdojë të përdoret nga

qeveria. E gjithë bota e përdor. Ne kemi vendosur në ligjin organik të buxhetit kufizime për PPP", tha Ahmetaj. Ndërkohë, vetëm pak ditë më parë qeveria vendosi

pezuillimin e koncesionit për ndërtimin e rrugës Thumanë-Kashar, duke i kaluar fondin e akorduar për këtë investim Paktit për Universitetin.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 16.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lirë për shpirtin e pasurisë së paluajtshme, Apartamenti me sipërfaqe totale 86.35 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 2/139/ND-1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lajgja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Cilirim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhema Xhafa me vlerë fillestare në ankand 32,468 (Trikjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com



Benet Beci

**Largohet kreu i KESH, Këshilli Mbikëqyrës i KESH miraton Benet Becin në krye të institucionit**

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare do të drejtohet tashmë nga Benet Beci, që më parë ka mbajtur detyrën e drejtorit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Këtë detyrë më parë e mbante Agron Hetoja. Referuar njoftimit zyrtar të KESH, "sot më datë 28.01.2019 Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë KESH s.h.a. me vendimin nr.02, datë 28.01.2019, ka pranuar dorëheqjen e administratorit të Shoqërisë Agron Hetoja dhe ka emëruar Benet Becin në detyrën e administratorit të shoqërisë". KESH ka publikuar edhe një letër dorëheqjeje të ish-kreut, që shkruan se jep dorëheqjen "për arsye personale". Në krye të KESH u njoftua emërimi i Benet Becit. Ai ka qenë në krye të Fondit Shqiptar të Zhvillimit që prej vitit 2005. Beci ka qenë edhe anëtar i Komitetit të Kontrollit të Bankës së Kreditit të Shqipërisë për periudhën shtator 2005- janar 2008 si dhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për periudhën shkurt 2008-tor 2012. Pas largimit të Benet Becit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në krye të këtij institucioni është vendosur Dritan Agolli. Ky i fundit ka qenë më herët në Bashkinë e Tiranës gjatë kohës kur ajo drejtohej nga kryeministri Edi Rama. Në atë kohë Agolli do kishte disa role drejtuese fillimisht tek Punët Publike dhe më pas tek Planifikimi Urban i Bashkisë për të kaluar në fund si administrator.





# PROTESTA E STUDENTEVE REAGIMET

Flet eksperti për arsimin e lartë: Pakti për Universitetin, panik për stafet akademike

## "Protesta e studentëve dështoi, qeveria edhe më shumë"

Dr. Albano Zhapaj: Tani fjalën e kanë pedagogët

Volta Duro

Në dhjetor të vitit që lamë pas, mijëra studentë të universiteteve publike në vend protestuan fuqishëm për plotësimin e kërkesave që i kishin parashtruar qeverisë. Por me ardhjen e festave të fundvitit, ata u larguan dhe premtuan që do të vazhdonin çka kishin lënë përgjysmë në muajin janar. Por, studentët u tërhoqën nga sheshi dhe zgjodhën bojkotin e mësimit dhe ngujimin brenda fakulteteve. Por çfarë ndodhi me protestën masive dhe ku janë mijëra studentë që mbushën sheshin para MASR dhe Kryeministrit? Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", eksperti i arsimit të lartë, dr. Albano Zhapaj bën një analizë të thelluar për protestën e studentëve, dhe ai shpjegon se ku dështuan dhe si shpëton nga dështimi. Sipas tij, një sërë faktorësh, veçanërisht infiltrimi i elementëve të politikës, shuajtën vulllën dhe mijëra studentëve. Zhapaj thekson se fuqia që vjen nga bashkimi i pedagogëve me studentët do të ishte e papërbalueshme për qeverinë dhe i vetmi shpëtim për universitetin dhe të ardhmen e tij.

**Sipas mendimit tuaj si ekspert i arsimit të lartë, a ka dështuar protesta e studentëve?**

Mendoj se për sa i përket qëllimeve kryesore mbi të cilën u ndërtua si protestë, pra atyre katër kërkesave të famshme, mendoj se protesta ka dështuar. Studentët nuk përfituan ulje tarifash, nuk patën përmirësime në strukturën konviktore dhe



Dr. Albano Zhapaj

as ndonjë lehtësirë të dukshme e të prekshme. Përgjysmimi i tarifave vetëm për studentët e ekselencës, nuk e zgjidh kurrsesi problemin, pasi student quhet kushto i ri apo e re që hyn në auditorë dhe universitetit. Mendoj se kjo është thjesht një manovër e qeverisë për të përfituar kohë deri në shuarjen totale të protestës. Humbje tjetër e protestës është fakti që studentët u izoluan në vetvete, u vunë kundër pedagogëve, duke spostuar synimet dhe zbehur natyrën e protestës, dhe duke i dhënë krah qeverisë të justifikohet e më pas të devijonte kërkesat, duke bërë atë që donte vetë, e jo atë që kërkonin studentët.

**Çfarë sollli ndryshe kjo protestë?**

Pranoj se ka edhe një faktor të protestës, ajo e jehonës mediatike kombëtare e ndërkombëtare, sensibilizoi ndjeshëm opinionin, si dhe vuri qeverinë në pozita kritike

dhe reflektuese, të paktën formalisht, duke qenë se kjo e fundit ndryshoi pjesë të mirë të kabinetit. Më tej gjykoj se protesta e studentëve ishte tregues i çlirimit të frymëmarrjes nga ndotja e arrogancës qeverisë, ishte dëshirë për të mos e braktisur vendin, ishte dashuri e furishme për Shqipërinë, ishte një përbuzje e madhe kundër mediokritetit, injorancës, arbitraritetit dhe hajdutërisë pushtetare.

**Mund të na përshkruani një dinamikë të ngjarjeve që prej nisjes së saj në dhjetor deri më sot ku studentët janë tërhequr brenda auditorëve?**

Një dinamikë pozitive e protestës ishte uragani studentor i munguar për 28 vjet në Shqipëri, si shprehje e forcës vitale që ka një popull që ngihet kundër një qeverie të padrejtë. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se në ditët e para kur protesta u masivizua, pati efekte mjaft pozitive në vend, pasi rilindoi shpresa tek ndryshimi

### QELIMI I PROTESTES

Mendoj se për sa u përket qëllimeve kryesore mbi të cilat u ndërtua si protestë, pra atyre katër kërkesave të famshme, mendoj se protesta ka dështuar. Studentët nuk përfituan ulje tarifash, nuk patën përmirësime në strukturën konviktore dhe as ndonjë lehtësirë të dukshme e të prekshme.

për një jetë më të denjë dhe në vendin tonë dhe kundër emigrimit të detyruar rinor. Një dinamikë negative e protestës ishte se ajo u izolua në vetvete, mbajti larg protestuesit e tjerë, siç ishin protestuesit e Unazës së Re, dhe ndërkohë që u proklamua si protestë jo politike, del më vonë me idenë e krijimit të një force të re politike. Tashmë studentët, atë që nuk e bënë dot kur ishin shumë dhe të bashkuar, nuk mund ta bëjnë dot të ndarë e të përçarë, nga klasat ku janë ngujuar.

**Çfarë duhet të bënin ndryshe studentët për plotësimin e kërkesave të tyre?**

Studentët nuk duhet ta izoloni protestën, por përkundrazi ta masivizoni atë, duhet të ishin konsultuar më tepër e më mirë, qoftë me familjet apo qoftë me intelektualë e pedagogë më integritet, ndërkohë që duhet të protestonin përpara Kryeministrit dhe jo Ministrisë



Bojkoti i mësimit në Fakultetin e Shkencave Sociale

së Arsimit. Fakti që nuk vepruan kështu qysh në fillim ishte tregues se studentët nuk i kishin shumë të qarta idetë, dhe kishin nënvlerësuar aftësinë dhe pabesinë përçarëse të shumë institucioneve, duke filluar nga Policia e Shtetit, Shish-1, falangat e partisë në pushtet, e deri tek mediat e kontrolluara nga qeveria, të cilat punuan krah pushtetit, qoftë nën rrogoz apo haptazi. Duhet të pranojmë në parim se izolimi i çdo lloji proteste, sjell pasojë izolim të problemit dhe shuarje të ngadaltë të saj me kalimin e kohës.

**A pati ndërhyrje nga ekspozitë të forumeve aktuale dhe si ndikuan në lëvizjen e studentëve?**

Natyrishit që ishte e pritshme që të shumëfishoheshin përpjekjet e politikës për ta përvetësuar protestën, secila për interesin e vet, dhe deri këtu s'ka asgjë të çuditshme. Studentët duhet të kishin ditur të gjenin mbështetje edhe tek politika, mjafton që përkatësia e interesave të ishte e përbashkët dhe në koherencë me interesin kombëtar. Fatqëesia ishte se pushteti e kapi protestën, e lodhi, e çorientoi, e devijoi derisa shuahti në masivizimin e saj.

**Cilat ishin format e përdorura për këto lloje ndërhyrjesh?**

Duhet kujtuar se ka in-

dividë në krye të këtyrë pushteti që gjithë jetën janë trajnuar edhe jashtë vendit se si të bëjnë dhe ç'bëjnë protesta. Janë profesionistë. Ata bënë ç'ishte e mundur për t'i përçarë studentët protestues duke i çuar deri në pikën që t'i bënin ata të shkonin nga iluzionet në zhgënjime. I rrethuan ata me policë civilë, me shish-sa e sigurimsa, i trysuan e stresuan, futën ndër ta militantë e të paguar, u fotografuan e identifikuan për t'u shtrënguar prindërit, për ata studentë që i kishin diku të punësuar në shtet, ndërsa në të njëjtën kohë ushqyen kundërshtitë e brendshme mes studentëve protestues. Në këto kushte studentët u përballën me dy kundërshtarë; kundërshtarin e brendshëm, përçarësin e futur nga pushteti, dhe atë të jashtëm që është vetë qeveria. Dihet se kundërshtitë gjenerojnë pakënaqësi, pakënaqësitë provokojnë represion, studentët të zhgënjyer filluan të braktisnin protestën, përçarësit ngritën kokën, devijuan qëllimet e protestës dhe dështimi rrjedhimisht ishte i pashmangshëm. Studentët nuk duhet të binin pre e presionit të jashtëm dhe duhet të shkelonin e largonin elementët përçarës të brendshëm të futur aty nga pushteti, të

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III-të për shpëtim e pasurisë së paluajtshme, Arë me sip.1,500 m<sup>2</sup> me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Rafat Ramizi me vlerë fillestare në ankad 378,000 (Treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 27.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III-të për shpëtim e pasurisë së paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 112 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 161136, Vol.6, Fq.122, Zk.8516 në pronësi të Shoqëria "ADBRATKA BËTOW" Sh.P.K. me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankad 7,338.6 (Shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pike gjashtë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 1260 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 161 235, Vol.7, Fq.236, Zk.8516 në pronësi të Shoqëria "ADBRATKA BËTOW" Sh.P.K. me adresë Durres, me vlerë fillestare në ankad 82,555 (Tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) EURO. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 01.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i I-rë për shpëtim e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/229 , Zk. 8250, me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup> me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajjazi me vlerë fillestare në ankad 98,880 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) EURO. **Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.**



vazhdonin protestën se duke protestuar do t'u kthjelloheshin edhe më mirë idetë dhe do gjenin vetë mënyrat më të mira për zgjidhjen e problemeve të tyre. Fatkeqësisht kjo nuk ndodhi.

**A u plotësuan kërkesat e studentëve, pas miratimit të paktit për universitetin?**

Duhet kujtuar se fjala "Pakt" në vetvete nënkupton, në të gjitha gjuhët e botës, një marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë palëve për çështje të interesave të përbashkëta, marrëveshje kjo e bashkëpunuar dhe firmosur nga të gjitha palët e interesuara. Qeveria krijoi një dokument që nuk i përmbush absolutisht kushtet për t'u quajtur pakt. Nisur nga kjo premisë, as që bëhet fjalë për plotësim kërkesash, sepse po të lexosh me vëmendje këtë dokument të njëanshëm, e që shitet si pakt, kupton se qeveria po tenton të realizojë ëndrrën e saj të vjetër, atë të kapjes së universitetit publik. Në të vetëshpallurin "pakt" identifikohen qartësisht përpjekjet që po bën qeveria për të hedhur studentët kundër pedagogëve, të cilat janë tregues se ajo është kundër akademikëve, kundër universitetit publik, kundër shkollimit falas, e përse jo, kundër kulturës tonë kombëtare dhe evropiane.

**Si e vlerësoni qëndrimin e rektorëve dhe dekanëve ndaj protestës, ku shumë prej tyre kanë kërkuar që studentët t'i rikthehen mësim?**

Rektorët dhe dekanët nuk janë shprehur në shumicë që studentët t'i rikthehen mësim, kanë qenë disa syresh që janë vendo-

sur aty me pëlqimin e pushtetit, dhe kjo gjë dihet publikisht, mjaft të kujtojmë zgjedhjet e para tre viteve në universitet, ku pati ndërhyrje edhe nga bota e krimin. Ju kujtoj se faza e parë e vënies në provë të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, e megafonuar si sukses, pra ajo e zgjedhjeve të strukturave drejtuese në universitet, tregoi qartë se ligji dështoi, pikërisht nga paqartësia e tij mbi këtë proces dhe mungesa e akteve nënligjorë të vlefshëm, ku udhëzimi i atëhershëm i MASR i zgjedhjeve të MASR i penalizoi apo përjashtoi apriori profesorët e padëshiruar nga pushteti, duke bërë edhe që në disa universitete publike zgjedhjet për dekanë e rektorë të kryeshin me vetëm një kandidat. Fakti që pushteti ka kërkuar dhe kërkon të "shtjerë në dorë" universitetin publik, nuk përbën ndonjë gjë të panjohur në kontekstin shqiptar. Qeveria aktuale, falë ligjit të ri të arsimit të lartë, hyri në universitet kësaj here më shumë se çdo qeveri tjetër e mëparshme, dhe shtriu kontrollin e saj duke përdorur zgjedhjet për krerët drejtues të universiteteve tona publike. Logjika e thjeshtë na mëson se kur ke në dorë krerët e institucioneve, ke në dorë gjithë institucionin.

**Cili është mendimi juaj mbi mbledhjen e fundit të asamblesë së pedagogëve të UT-së?**

"Pakti për Universitetin" ka brenda tij disa pika që bien ndesh, jo vetëm me ligjin e arsimit të lartë dhe natyrën specifike të profesionit të akademikut, por

**Dekani Artan Hoxha, kërkesë Ministrisë së Arsimit: Duam ambiente të reja për leksionet**

# Konflikt e tension te Juridiku, studentët ndahen në dy grupe

## Hapen dyert me forcë nga ata që duan mësim

Voltiza Duro

Disa prej studentëve të universiteteve publike në vend vazhdojnë bojkotin e mësimit deri në plotësimin e kërkesave të parashtruara. Tashmë studentët janë ndarë në dy grupe: ata që dëshirojnë të zhvillojnë mësim dhe grupi tjetër bojkotues. Ditën e djeshme, këto dy grupime kanë pasur konfrontime në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, pasi studentët bojkotues kanë bllokuar derën me karriqe e tavolina dhe nuk kanë lejuar pjesën tjetër që të futen në auditor për mësim. Të rinjtë që dëshirojnë të kthehen në mësim, duke thërritur njëzëri "Duam mësim!", kanë hequr karriqet nga dera e fakultetit, çka ka sjellë edhe reagim të revoltuar nga të ngjuaruarit brenda godinës. Këta të fundit kanë hedhur akuzë mbi të rinjtë që duan të zhvillojnë mësim duke i quajtur pjesë të "FRESH". "Të largohen, sepse ne i njohim shumë mirë, e dinë që janë pjesë e forumit rinor të Partisë Socialiste. Ne kemi të drejtën e protestës, është një e jona dhe jetojmë në demokraci. Qëndresa jonë do të vazhdojë deri në plotësimin e 8 kërkesave. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", - thotë për "GSH" një prej studentëve të Drejtësisë.

**KËRKESA E DEKANIT**

Pas tensioneve të shumta mes studentëve të Drejtësisë, dekan i këtij fakulteti Artan Hoxha i ka drejtuar një kërkesë Ministrisë së Arsimit në të cilën ka kërkuar ambiente për zhvillimin e procesit mësimor. "Duam ambi-



Dje në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë

**QËNDRESA**

Në një kohë që një pjesë e studentëve u janë rikthyer auditorëve, pjesa tjetër vijon bojkotin e mësimit. Përkatësisht studentët e Filologjikut, Gjuhëve të Huaja, Shkencave Sociale e Shkencave të Natyrës nuk heqin dorë nga qëndresa e tyre. Ata shprehen të vendosur për pezullimin e mësimit deri në plotësimin e 8 kërkesave



**AKUZAT**

"Të largohen, sepse ne i njohim shumë mirë, e dinë që janë pjesë e forumit rinor të Partisë Socialiste. Ne kemi të drejtën e protestës, është një e jona dhe jetojmë në demokraci. Qëndresa jonë do të vazhdojë deri në plotësimin e 8 kërkesave. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", - thotë një prej studentëve të Drejtësisë.



ente të tjera për të bërë mësim, pasi këtë e kërkon shumica e studentëve. Ambientet tona ne i kemi të bllokuara për shkak të ngujimit të një pjesë studentësh". thotë dekan i Juridikut në kërkesën e tij drejt MASR.

**BOJKOTI I MËSIMIT**

Në një kohë që një pjesë e studentëve u janë rikthyer auditorëve, pjesa tjetër vijon bojkotin e mësimit. Përkatësisht studentët e Filologjikut, Gjuhëve të Huaja, Shkencave Sociale, e Shkencave të

Natyrës nuk heqin dorë nga qëndresa e tyre. Ata shprehen të vendosur për pezullimin e mësimit deri në plotësimin e 8 kërkesave të parashtruara qeverisë si dhe rrezimin e ligjit për arsimin e lartë.

"Bojkoti po vazhdon dhe jemi ende në këmbë. Do ta mbajmë dhe këtë javë deri sa javën tjetër presim dhe mbështetjen masive të pedagogëve që i kanë lënë afat deri në datën 1 shkurt qeverisë", - shprehet për "Gazeta Shqiptare" një student i Fakul-

**titet të Shkencave Sociale. UNIVERSITETI I DURRËSIT**

Ditën e djeshme, një grup studentësh të universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës kanë pezulluar mësimin dhe kanë protestuar që në orët e para të mëngjesit në kampusin e Spitalës. Edhe studentët e këtij universiteti, kërkojnë plotësimin e kërkesave të parashtruara qeverisë, ndërkohe që pjesa më e madhe e tyre i është rikthyer auditorëve e po vijon mësimin normalisht.

edhe me kodin e punës. Këtë gjë s'ka pedagog që mos ta dijë dhe mbledhja e fundit e asamblesë së pedagogëve të UT-së mund të sjellë risi në vazhdimësinë e plotësimit të kërkesave të studentëve. Pikëpyetja e madhe që duhet ngritur dhe i duhet dhënë përgjigje është se përse qeveria po kërkon me ngulm të godasë pedagogët, dhe jo t'i përgjigjet kërkesave konkrete të studentëve. Asambleja e Pedagogëve të UT-së, më shumë se kushdo tjetër e di mirë se pushtetit nuk i pëlqen që pedagogët kanë

"defektin" e të bërit oponencë politikave apo vendimmarrjeve të gabuara të kujtdo qeverie, ku një pjesë e mirë e tyre janë profesionistë të mirëfilltë dhe i përkushohen më tepër edukimit të brezit të ri sesa idealeve të partisë. Dihet se në arsimin universitar, ka ekzistuar së tepërmi dhe ekziston një rezistencë e caktuar përkundrejt ndikimit të pushtetit në arsimin e lartë, dhe kjo gjë shqetëson natyrshëm realizimin e qëllimit qeveritar, atë të dhënies jetëgjatësi karriges së pushtetit. "Pak-

ti për Universitetin" synon të krijojë panik për stafet akademik, duke krijuar kushtet për dominim total të universitetit, si fillim nëpërmjet kontrollit të pozicioneve drejtuese njerëzve të pushtetit e më tej administrimit dhe emërimeve klienteliste, ku kriter primar kualifikues të jetë shërbimi ndaj pushtetit. Gjykoj se përfshirja e pedagogëve për të kundërshtuar krizën e sotme në arsimin e lartë ka zbuluar edhe fytyrën e vërtetë të pushtetit. Vendimet e asamblesë së pedagogëve të UT-së në rast se arrijn të mobilizojë

gjithë stafet akademike edhe në universitetet e tjera publike, do të sjellë të papritura jo të këndshme për qeverinë dhe pushtetin. Fuqia që vjen nga bashkimi i pedagogëve me studentët do të ishte e papërballeshme për qeverinë dhe i vetmi shpëtim për universitetin dhe të ardhmen e tij. Sa më shpejt ta kuptojë pushteti që rrënimin e arsimit të lartë është rrënimin e Shqipërisë, aq më mirë do të jetë, përndryshe bashkimi student-pedagogë do të bëjë që gropa e hapur në arsimin e lartë, të përpjëtë parët ata që e hapën.

Mbledhja e këshillit bashkiak në 31 janar/ Vendimet që priten të miratohen

# Zbardhen emrat e 2924 familjeve që do të marrin ndihmë ekonomike

## Lista e dytë, ja kush do të përfitojë pagesë

Voltiza Duro

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, priten që të miratohet edhe ndihma ekonomike për 2924 familje në kryeqytet. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e dytë të emrave që priten të marrin këtë pagesë, pas miratimit në mbledhjen e 31 janarit. Mes këtyre familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike, ka dhe persona me statusin e jetimit,



Mbledhje e këshillit bashkiak

viktima të dhunës në familje, individë viktima të trafikimit apo edhe familjet me shumë fëmijë. "Kanë aplikuar për ndihmë

ekonomike 2470 familje; Individë me statusin e Jetimit 283 persona, me një fond 849000; Individë viktima të trafikimit 5 persona, me një

fond 15000 lekë, lista bashkëlidhur; Individë viktima të dhunës në familje 93, me një fond 279000, lista bashkëlidhur", theksohet në ven-

dimin nr.1 të datës 15 janar 2019. Në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo ndihmë ekonomike do të përfitojnë edhe: Individë prindër të fëmijëve të lindur: Trinjakë, 17 familje, me një fond 153000 lekë; Katërnjakë, 4 familje, me një fond 64000 lekë; Pesënjakë, e më shumë njëherësh 1 familje, me një fond 25000 lekë.; Fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare 48 aplikime, me një fond 432000 lekë; Fëmijë me aftësi të kufizuar në kujdestari 3 aplikime, me një fond 30000 lekë. Në mbledhjen e 31 janarit të Këshillit Bashkiak të

Tiranës, priten të miratohet edhe projektvendimi për pagesën e personave me aftësi të kufizuar, si dhe miratimi i kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfutuese. Gjithashtu, do të jenë në shqyrtim edhe projektvendimet për miratimin e familjeve përfutuese dhe fondeve nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind si dhe miratimin e listave të nxënësve të arsim-it parauniversitar si dhe studentëve të arsimi të lartë që do të përfitojnë bursa për vitin mësimor 2018-2019.

Table with 8 columns: Nr., Emri atesia mbiemri, Nr. dosje, Nr. anëtarëve, Nr., Emri atesia mbiemri, Nr. dosje, Nr. anëtarëve, Nr., Emri atesia mbiemri, Nr. dosje, Nr. anëtarëve, Nr., Emri atesia mbiemri, Nr. dosje, Nr. anëtarëve

Table with 10 columns: Name, Date of Birth, Gender, Age, and Address. The table lists numerous individuals and their personal details, organized in three columns across the page.

Rrëfhet ish-banorja e 'BB': Ja sakrificat më e madhe që kam bërë

# Dona Pjetri: Te "Gjurma pa shenjë" po jetoj si femër tjetër

"Televizioni është në planet e mia"

Egla Xhemali

**B**ukuroshja nga Shkodra, Dona Pjetri, pas daljes nga "Big Brother", në të cilin arriti të shkonte deri në gjysmëfinale nuk iu nda jetës së televizionit. E ftuar në intervista të ndryshme si modele mjaft e pëlqyer dhe me një jetë tejet aktive, ajo arriti t'i mbannte sytë drejtuar nga vetja. Në rrjetet sociale Dona ndan me fansat foto profesionale për kompani të ndryshme mode, 'make-up'-i, si edhe në videoklipe. Pjetri gjithashtu zbulon vendet që zgjedh të vizitojë për pushime si Milano, Roma, Venecia, ku ka realizuar sete fotografike të ndryshme. Ajo u vu në qendër të portalet 'online' para pak kohësh, ku dhe qarkulloi një foto e saj me fustan nusërie. U dyshua për një dasmë, megjithatë çdo gjë u qartësua. Ish-banorja e 'BB' do të jetë pjesë e një filmi me titull "Gjurmë pa shenjë", për të cilin kanë nisur xhirimet dhe shpejt pritet të shfaqet në kinema me një fabul dramatike, por që në fund triumfon dashuria. Për "Gazeta shqiptare" Dona tregon detaje për rolin në film, pritshmëritë që ka për të, për raportet me konkurrentët e 'BB', si dhe për botën e televizionit.

**Si ka ndryshuar jeta e Donës që pas daljes nga "Big Brother"?**

Nuk ka ndryshuar asgjë, pasi bëj po të njëjtën jetë që kam bërë para "Big Brother"-it, përveç faktit që njerëzit më njohin më shumë se më parë.

**Konkurenti me të cilin mban akoma kontakte?**

Mbaj kontakte pothuajse me të gjithë. Janë shumë që të t'i përmend.

**Ke treguar që televizioni është një nga pasionet e tua. Ke marrë ndonjë ofertë për t'u bërë pjesë e tij?**

Jo, nuk kam marrë, sepse jam fokusuar shumë në projektet e tjera si filmi, por nuk i dihet. Mund të them që është në planet e mia.

**Programi që do të përshatet për prezantim?**

Një program 'show' do e bëja me kënaqësi, por diçka komplet ndryshe nga çfarë kemi parë deri më tani. Nuk do doja të kopjoja e aq më tepër të bëja pak ndryshim siç janë bërë shumica dhe s'është aspak interesante t'i shohësh. Të njëjtat lojëra, të



njëjtët personazhe etj. **Tani ke nisur dhe rrugën si aktore. Cila është e veçanta e personazhit tënd te "Gjurmë pa shenjë"?**

Në fakt, kam nisur xhirimet në Filmin "Gjurmë pa shenjë" me regji të Maxim Alidini, mikut tim, por që dhe kemi rastin të aktrojmë përkrah njëri-tjetrit. E

veçanta është se jam personazhi kryesor femër.

**Çfarë nënkupton titulli i filmit? Cilin zhanri i përkaket?**

Vetë "Gjurmë" është shenjë në vetvete, por që kjo "Gjurmë" qenka pa shenjë. Mbase shenjat që ka lënë ajo qenkan kaq të mëdha sa fjala "gjurmë" s'do të ishte e du-

hura për ta përkufizuar. I përket zhanrit romancë-dramë dhe aksion.

**Sa e vështirë ka qenë të hysh nën petkun e personazhit që të është besuar?**

E vështirë ka qenë, sepse për mua është sikur po jetoj jetën e një femre tjetër, e cila në ndryshim nga unë është shumë e dashuruar,



por që ngjasojmë në disa kritere si kokëfortësia, këmbëngulja dhe sigurisht besimi e siguria në vetvete.

**Pritshmëritë që ke për filmin?**

Pritshmëritë sigurisht që janë të mëdha, pasi ky film po bëhet më shumë sesa për tregun shqiptar. Po bëhet art i mirëfilltë dhe sigurisht që

do jetë nëpër festivalet e filmit kudo në Europë e më gjerë.

**Përkufizimi që do i jepje lumturisë?**

Sukses... **Sakrificat më e madhe që të është dashur të bësh deri më tani?**

Të jetoj larg familjes pa diskutim.



## E "demaskoi" publikisht Marinën, Luana bëri veprimin që na befaso!

Motrat Vjollca janë ndër moderatoret më të bukura dhe të preferuarat e publikut shqiptar. Prej vitesh i kemi parë në të njëjtin televizion, por ato i "ndanë rrugët". Por, mesa duket motrat Vjollca janë si të gjitha të tjerat në përditshmërinë e tyre. Ato mbajnë edhe "mëri" mes njëra-tjetrës. Rasti më i fundit është publikimi që Luana ka bërë në "Instagram". Luana quan ordinere me shaka motrën e saj Lirën, e cila ka dalë të darkojë me Marinën. Kështu është krijuar një "sherr" mes motrave, sa i këndshëm dhe real, por që në fund Lira tha që e preferuara e saj është Luana dhe kjo e fundit nuk mund të mos e ndante me ndjekësit e saj këtë gëzim. Mirëpo foto nuk qëndroi gjatë në profilin e saj në "Instagram", pasi Luana e fshiu. Mos vallë është ndër një keq Marina dhe Luana i ka bërë qejfin?




## I kujtuan modifikimin e zërit, Enca u bën 'diss' të gjithë këngëtarëve shqiptarë

Enca është padyshim një prej këngëtareve më ekstravagante dhe më të komentuarara në 'showbiz'-in shqiptar. Bukuroshja di gjithmonë si të qëndrojë në qendër të vëmendjes me fotot provokuese, por edhe me projektet muzikore që gjithmonë kthehen në hite. Së fundmi, Enca ka festuar dhe faktin se është artistja shqiptare me më shumë ndjekës në "Instagram", duke u renditur e para dhe duke lënë pas Noizyn dhe Luanën. Mirëpo komentet në "Instagram"-in e Encës nuk janë gjithmonë shumë të ëmbla. Një prej ndjekëseve të saj ka komentuar se si këngët e saj plot me autotune, por Enca nuk e ka lënë të kalojë lehtë ky koment. Këngëtarja ka treguar se në fakt përdorimi i autotune nuk tregon nëse një këngëtar di apo jo të këndojë, por është një mjet për t'u dhënë këngëve stilin e duhur.



## "Duhemi akoma", Fifi bën deklaratën e papritur për Florin

Këngëtarja e njohur Fifi është ndër artistet më të dashura për publikun dhe njëkohësisht, ndër zërat më të pëlqyer të skenës shqiptare. Kohët e fundit lajmi i lidhjes së saj me Florin Mumajesin mori dhenë dhe dyshja u argëtuan mjaft me titujt rozë që iu kushtuan atyre. Teksa ishin të ftuar në "Shiko Kush Luan", Flori tha për Fifin se ajo ishte e dashura e tij e portaleve. Dhe video e famshme ku shfaqeshin duke aktruar në mënyrë të shkëlqyer si dy të dashuruar u komentua shumë, por dy artistët mohuan se janë në një lidhje dhe u shprehën se mes tyre ka vetëm miqësi. Por, para pak ditësh ata i habitën të gjithë fansat pasi hoqën njëri-tjetrin nga "Instagram"-i. E pyetur nga "iconstyle" për këtë veprim, Fifi u shpreh se kjo ishte një temë shumë private, mirëpo pavarësisht ç'ka ndodhur, këngëtarja ka treguar hapur se ajo dhe Flori duhen akoma. "Besoj që është pak si shumë private si temë, por gjithsesi në besoj se jemi miq me Florin dhe duhemi akoma", - ka rrëfyer Fifi.



## Sara "braktis" djalin, ja kush i vjen në ndihmë

London Noor Liço është pa diskutim gëzimi më i madh në familjen Liço-Hoxha. Ai po rritet shumë shpejt dhe Sara e publikon shpesh në "Instagram". Mirëpo Sara ka shkuar me pushime së bashku me partnerin e saj, Ledion Liço, por nuk e kanë marrë Londonin me vete. E siç duket, trashëgimtarja e "Top Channel" është mërziutur shumë nga ky fat, sa që ndihet në ankth dhe këtë na e tregoi me anë të një postimi në "Instagram". "Mund të duket sikur po kënaqem, por ndjenja e fajit prej nëne dhe ankthi i ndarjes nuk po më lënë të shijoj asgjë", - shkruan ajo në foton e publikuar dje. Megjithatë, si për ta qetësuar sadopak motra e saj e vogël, Redia nuk ka nguruar të komentojë duke theksuar se 'Dondon' është në duar të sigurta.



**Stolteberg: Maqedonia mund të anëtarësohet në NATO për një vit**

**Opozita maqedonase kërkon dorëheqjen e Zoran Zaev dhe zgjedhje të reja për vendin**



tërë procedurën e finalizimit të anëtarësimit, Stolteberg për mendim anëtarësimin e Malit të Zi, që sipas tij është dashur një vit. Kjo lë për të

**JENS STOLTENBERG**

"Sapo të nënshkruajmë Protokollin, Maqedonia do të ulët në tryezën tonë, por anëtare e plotë do të jetë vetëm pasi që të ratifikohet marrëveshja nga Parlamentet e 29 vendeve anëtare", theksoi Stolteberg.

nga Parlamentet e 29 vendeve anëtare. "Sapo të nënshkruajmë Protokollin, Maqedonia do të ulët në tryezën tonë, por anëtare e plotë do të jetë vetëm pasi që të ratifikohet marrëveshja nga Parlamentet e 29 vendeve anëtare", theksoi Stolteberg. Duke folur për

nënkuptuar se procesi i anëtarësimit do të përmbyllet gjatë vitit 2020. Ndërkohë opozita maqedonase do të kërkojë zyrtarisht dorëheqjen e Kryeministrit Zoran Zaev dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Grupi parlamentar i VMRO-DPMNE-së do t'ia dorëzojë kërkesën parlamentit. Lideri i opozitës Kristijan Miçkovski akuzoi kryeministrin Zaev për kapitullim të plotë për marrëveshjen e emrit, por edhe me reformat në ekonomi. Sipas tij, qeveria po e çon vendin drejt humnerës.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stolteberg theksoi se gjatë kësaj jave, ambasadorët e vendeve anëtare të NATO-s mund ta nënshkruajnë Protokollin për hyrjen e Maqedonisë në NATO. Në një deklaratë për "Politiko Evropa", Stolteberg ka nënvizuar se protokollin do të nënshkruhet sa më shpejt, por për ratifikimin e tij do të duhet më shumë kohë dhe do të varet

Zëdhënësja e Bashkimit Evropian i kërkon Serbisë normalizim të marrëdhënieve fqinjësore

**Koçijançiq: Që të vazhdojë dialogu, Kosova duhet të heqë taksën**

*Haradinaj, letër ambasadorëve të Quint-it dhe BE-së për tarifën*

Përfundim të dy muajsh Bashkimi Evropian është duke bërë presion qeverisë "Haradinaj" për heqjen e taksës 100% ndaj mallrave serbe, në mënyrë që të vazhdojë dialogu me Serbinë. Zëdhënësja e BE-së, Maja Koçijançiq, në një reagim për gazetën "Zëri" ka thënë se Brukseli pret të hiqet taksata dhe të dyja vendet të angazhohen për vazhdimin e dialogut. Teksa ka thënë se pozicioni i Bashkimit Evropian mbi tarifën e vendosur ndaj produkteve serbe është bërë më se i qartë në mënyrë të vazhdueshme, zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Koçijançiq ka deklaruar për "Zërin" se marrëveshja finale mes Kosovës e Serbisë kërkon një klimë, e cila çon drejt raporteve të mira në mes të dyja vendeve. "Arritja e një marrëveshjeje ligjore gjithëpërfshirëse për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Beogradit e Prishtinës kërkon një klimë, që kontribuon në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, ku marrëveshjet e kaluara respektohen dhe zbatohen plotësisht", ka thënë Koçijançiq. Po ashtu për të ardhur deri të një marrëveshjeje të tillë, sipas saj duhet të shmangen edhe deklaratat e veprimet, të cilat nuk janë në përputhje me interesat e përgjithshme dhe objektivat strategjike të rajonit. "BE-ja pret që Serbia dhe Kosova të shfaqin angazhimin e shpejtë të tyre ndaj dialogut, duke pasur parasysh lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis tyre dhe perspektivave konkrete për aspiratat e tyre në BE"-ka thënë Koçijançiq. Ndërkohë teksta ka folur për Serbinë, Koçijançiq ka thënë se si një shtet kandidat për anëtarësim në BE, Serbia duhet të angazhohet për normalizim të plotë, për pajtim, për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për bashkëpunim racional. Por nuk ka treguar nëse ka pasur presion e kritikë edhe ndaj Serbisë për veprimet e ndërmarra kundër Kosovës, siç ka pasur presion dy muajt e fundit ndaj Kosovës për ta hequr tarifën 100%. Ndërkohë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj u ka dërguar dy një letër ambasadorëve të Quintit dhe atyre të BE-së në Kosovë. Përmes



Zëdhënësja e BE-së, Maja Koçijançiq

letër, Haradinaj sqaron pse e ka marrë vendimin për taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Shefi i qeverisë së Kosovës, në letër ka shkruar se taksata do të hiqet nëse SHBA-ja dhe BE-ja organizojnë një konferencë, ku do të sigurohet njohja e Kosovës nga Serbia. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Bashkimi Evropian (BE), pas marrjes së hapave praktik për nisjen dhe mbështetjen e një konference ndërkombëtare me qëllim e arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërimit të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të pazgjidhura ndërmjet dy vendeve - konferenca duhet të fillojë sa më parë që është e mundur pas plotësimit të rrethanave të përshtatshme të paragrafët 2 deri në 5 më poshtë dhe duhet të përfundojë brenda 14 ditëve", thuhet në letër e Haradinajit.

**LETRA E PLOTË:**

Pas marrjes së vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND-së) se shpallja e pavarësisë nga ana e Kos-

ovës në vitin 2008 nuk ishte e paligjshme, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën nr. 64/298 (2010), e cila njohu përmbytjen e Opinioni të GJND-së dhe mirëprirë "gatisshmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet palëve". Ne kemi bindje të thellë që mund të arrihet në vitin 2019 një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërimit të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila do t'i adresojë të gjitha çështjet e pazgjidhura, duke përfshirë reparacionet e luftës, të drejtat e minoriteteve në të dyja vendet, si dhe çështjet e ndryshme ekonomike, sociale dhe kulturore - duke shpjer në njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Më 21 nëntor 2018, Qeveria e Kosovës vendosi një taksë prej 100% (taksat) mbi importin e mallrave me origjinë nga Serbia si dhe nga Bosnja dhe Hercegovina. Taksat ka ardhur si përgjigje ndaj shkeljeve të vazhdueshme të Mar-

rëveshjes për Tregti të Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) dhe akteve të vazhdueshme të agresionit që kanë për qëllim dëmtimin e shtetit të Kosovës. Qeveria e Kosovës do të pezullojë menjëherë tarifën në rast se plotësohen rrethanat e mëposhtme: Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Bashkimi Evropian (BE), pas marrjes së hapave praktik për inicimin dhe mbështetjen e një konference ndërkombëtare ("Konferenca") me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërimit të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të pazgjidhura ndërmjet dy vendeve - konferenca duhet të fillojë sa më parë që është e mundur pas plotësimit të rrethanave të përshtatshme të paragrafët 2 deri në 5 më poshtë dhe duhet të përfundojë brenda 14 ditëve: SHBA-të dhe BE-ja do të japin zotime publike dhe do të garantojnë që në Konferencë nuk do të ketë: Çfarëdo rivendosje të kufijve ekzistues të Kosovës, ose ndarje të Kosovës, ose sh-

këmbime territoriale të çfarëdo natyre. Dhënie të kompetencave ekzekutive të çfarëdo forme për asociacionin e komunave serbe në Kosovë ose ndonjë marrëveshje tjetër që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Masa të çfarëdo natyre të bazuar në koncesione që shkojnë para datës 17 shkurt 2008. BE-ja do të jep zotime shtesë publike dhe do të garanton se: Do të hyjë në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës para fillimit të Konferencës; Do të zbatohet dhe do të jetë plotësisht funksionale Marrëveshja për Energji e Arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë para fillimit të Konferencës. Është verifikuar se Serbia ka larguar të gjitha barrierat jo-tarifore të shaktuara ndaj lëvizjes së mallrave nga Kosova, si dhe të gjitha kufizimeve

të paligjshme në tregtinë e shërbimeve dhe lëvizjen e njerëzve nga Kosova në Serbi. Presidenti, Kryeministri ose Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë konfirmojnë publikisht se janë ndaluar në mënyrë permanente të gjitha politikat dhe veprimet e çfarëdo lloji të drejtuara kundër aspiratave të Kosovës si shtet sovran qoftë në ato aplikohen në nivel lokal, rajonal apo ndërkombëtar. Tarifa do të rivendoset menjëherë nëse Konferenca nuk përfundon me një marrëveshje gjithëpërfshirëse të detyrueshme mes Kosovës dhe Serbisë, e cila siguron, ndër të tjera, njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Tarifa do të rivendoset në një datë të mëvonshme nëse nuk arrihet të zbatohet marrëveshja gjithëpërfshirëse e detyrueshme e arritur në Konferencë.

**Korrigjimi i kufijve të Kosovës, presidenti slloven: S'do e hidhja poshtë**

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Beograd. Ai ka folur edhe rreth çështjes së dialogut mes Kosovës dhe Serbisë me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq. Pas takimit me presidentin e Serbisë Aleksandar Vuçiq, ai ka folur rreth idesë për korrigjimin e kufijve ndërmjet Serbisë e Kosovës si mënyrë për t'u zgjidhur konflikti ndërmjet dy vendeve. "Zgjidhja e problemeve ndërmjet Serbisë e Kosovës përmes korrigjimit të kufijve kërkon shumë mençuri, shumë përkushtim ndaj zgjidhjes paqësore dhe shumë besim të shteteve të tjera, sepse ai është proces që nuk bën t'u sjellë dem vendeve të tjera në rajon", citon "Fonet" të ketë thënë Pahor. Ai këtë ide e ka quajtur të guximshme. "Nuk do ta kisha hedhur poshtë, por do të kisha qenë shumë i kujdesshëm", ka thënë në fund Pahor.





**Shembet diga në Brazil, 58 të vdekur 305 të zhdukur**

**Tragjedia në provincën Belo, nxirren nga balta mbi 192 persona, një autobus është përmblytur**

Tragjedia në Brazil si pa sojë e shembjes së një dige, ku kanë humbur jetën 58 persona dhe 305 rezultojnë të humbur. Ky është bilanci i viktimave të shkaktuara nga shembja e digës Mina Corrego do Feijao, në Brumadinho, në provincën Belo horizonte në Brazil ditën e djeshme. Lajmin e ka bërë të ditur agjencia Brasil. Koordinatori i mbrojtjes civile Flavio Godinho, ka shuar që forcat e ndihmës së



shpejtë kanë nxjerrë nga balta më shumë se 192 njerëz. Po kërkohet për të gjetur një autobus i mbuluar nga balta dhe uji me një numër të papërcaktuar personash në bord. Nuk dihet ende shkaku i shembjes së digës, të zotëruar nga Vale, kompania më e madhe e minierave. Ministria e mjedisit e ka gjobitur kompaninë në fjalë

me 66 milionë dollarë dhe është nën shqyrtim për shkeljen e rregullave dhe ndotjen në prag të katastrofës. Autoritetet kanë bërë të ditur se mes të zhdukurve janë mbi 200 punonjës që kishin ngrënë drekë në zonën administrative të digës kur ndodhi edhe shembja. Sakaq, bëhet e ditur se 366 persona janë shpëtuar,

ndërsa 23 janë dërguar në spital për ndihmë të menjëhershme. Dëmtime kanë pësuar edhe disa shtëpi, automjete dhe hapësira të mëdha të tokës bujqësore. Në vitin 2015 një tjetër digë e minierave u shemb në të njëjtin shtet të Minas Gerais në Brazil, duke vrarë 19 persona. Diga administrohej sërish nga e njëjta kompani së bashku me një kompaninë australiane të minierave "BHP Rënia e digës në 2015 lëshoi një sasi të madhe mbetjesh hekuri toksike përgjatë qindra kilometrave.

**SHKURT**

**Peru, dasma**

**kthehet në tragjedi**

Një dasmë në qytetin ka përfunduar në tragjedi pasi muri i hotelit ku ishin mbledhur më shumë se 100 dasmorë u shemb duke vrarë 15 prej tyre dhe plagosur 29 të tjerë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Alhambra Hotel, ku pothuajse gjysma e dasmorëve ishin në afërsi të murit në momentin që u rrëzua. Media lokale raporton se në zonë ka pasur reshje të dendura shiu ditë e fundit. Autoritetet dyshojnë se muri i hotelit është shembur pikërisht nga rrëshqitja e dheut. Autoritetet kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

**Turqi, burrin e shqyejnë**

**kafshët e egra në pyll**

U nis për të kontrolluar bagetinë në pyll, por kafshët e egra i morën jetën. Kjo është historia tragjike e 54-vjeçarit Recep Karaca nga provinca Zonguldak e Turqisë. Sipas agjencisë turke të lajmeve "IHA", me të përdunuar dielli, 54-vjeçari u largua nga fshati i tij në drejtim të pyllit ku kishte bagetinë, por nuk u kthye më. Familjarë dhe bashkëfshatarë të shqetësuar nga mungesa e tij, nisën kërkimin në pyll, ku gjetën edhe trupin e pajetë të Karaca rreth orës 23:00. Pas njoftimit nga familjarë, në vendngjarje mbërritën ekipet e xhandarmërisë. Inspektimet paraprake provuan se burri ishte kafshuar nga kafshë të egra. Grupi hetimor e ka dërguar trupin e tij për autopsi, ndërsa në zonë ka nisur një hetim për zbardhjen e plotë të ngjarjes tragjike.

**SHBA, pushohen nga**

**puna 12 emigrantë**

12 punonjës emigrantë në një nga klubet e golfit të Presidentit Donald Trump në Nju Jork që janë në Shtetet e Bashkuara ilegalisht, u pushuan nga puna këtë muaj, megjithëse menaxherët kishin qenë në dijeni të statusit të tyre për vite me radhë, tha të shtunën një avokat i punonjësve. Ndërsa presidenti fliste ashpër kundër emigrantëve të paligjshëm gjatë mbylljes së qeverisë, një menaxher në Klubin Kombëtar të Golfit në Distriktin Eëstchester i thirri 12 punëtorët një nga një më 18 janar dhe i pushoi nga puna, tha avokati Anibal Romero. Shumë prej tyre kishin punuar në klub për mbi 10 vjet, tha ai dhe menaxherët e dinin që kishin dorëzuar dokumente të rreme, por bënë sikur nuk e kishin kuptuar. Pushimet erdhën pasi disa punëtorë në një klub tjetër të zotit Trump në Nju Xhersi thanë muajin e kaluar se menaxherët i kishin punësuar duke e ditur që ishin ilegalisht në vend dhe madje e kishin ndihmuar një prej tyre të siguronte dokumente të rreme. Të dielën presidenti Trump shkruante në Twitter lidhur me koston dhe numrin e lartë të emigracionit të paligjshëm.

Kaosi që shkaktoi tornadaja ditën e diel në Ankara të Turqisë ka bërë që të paktën 12 persona që prisnin të hipnin në një aeroplan në të fuqishme. Tornadaja e fuqishme shkaktoi dëme të konsiderueshme tek dy aeroplanë dhe rrëzoi disa autobusë. Udhëtarët që prisnin të hipnin në aeroplan në Aeroportin Ndërkombëtar të Antalias, filmuan pamjet e stuhisë së fuqishme të shtunën, që shkaktoi rrëzimin e avionëve. Një Airbus A321-231 dhe një Boeing 737-MAX8 u dëmtuan pas stuhisë së fuqishme. Përveç kësaj, u dëmtuan edhe dy autobusë, dy minibusë, 2 ashenzorë në aeroplan dhe një helikopter policie. Të paktën 12 pasagjerë u plagosën ndërsa në një autobus priste të hipte në bord, sipas guvernatorit të provincës së Antalias, Munir Karaloğlu, megjithatë aeroporti ka mbetur i hapur për trafikun ajror. "Një uragan ka kaluar për mes aeroportit dhe u kthye mbi një autobus që po transferonte udhëtarët në një aeroplan. Si rezultat, 12 persona u plagosën", i tha Karaloğlu transmetuesit turk NTV. Autoritetet turke paralajmëruan edhe për stuhi të tjera në ditët në vijim. Guvernatori i Antalias, Mounir Karaloğlu sqaroi se dymbëdhjetë persona janë plagosur dhe dy mjete transporti u përmbysën nga tornado. "Në pistën e aeroportit, dy avionë dhe një helikopter i policisë janë dëmtuar", shtoi ai. Sipas guvernatorit, kjo tornado është e pesta në vetëm katër ditë. Autoritetet lokale paralajmëruan popullsinë në "Twitter" të jenë të kujdesshëm ndaj rrezikut të tornadove të tjera në këtë provincë, të shoqëruara me erëra të fuqishme, përmblytje dhe stuhi. Agjencia zyrtare e lajmeve "Anadolu" raportoi të enjten e kaluar për dy të vdekur dhe dhjetë të plagosur gjatë një tornado që goditi zonat e Kumluca dhe Finike, në të njëjtin rajon. Ndërkaj, pamjet u regjistruan të shtunën, nga pasagjerë, të cilët prisnin të hipnin në avion, në Aeroportin Ndërkombëtar të Antalias. Pasagjerët e lënduar ndodheshin në një prej autobusëve, në pritje për të hipur në avion. Stuhitë e fu-

Katastrofa e pestë natyrore në katër ditë, guvernatori: Do të ketë të tjera

**Turqia në kaos, tornado 'shkatërron' aeroportin**

*Rrëzohen dy aeroplanë dhe disa autobusë, 12 persona të lënduar*



Tornado në aeroportin e Ankarasë në Turqi

**MOUNIR KARALOGLU**

"Një uragan ka kaluar përmes aeroportit dhe u kthye mbi një autobus që po transferonte udhëtarët në një aeroplan. Si rezultat, 12 persona u plagosën. Në pistën e aeroportit, dy avionë dhe një helikopter i policisë janë dëmtuar", tha Karaloğlu.

**Zgjedhje të parakohshme në Venezuelë? Maduro hedh poshtë zërat**

Udhëheqësi i Venezuelës, Nicolas Maduro hodhi poshtë të dielën kërkesat ndërkombëtare për të shpallur zgjedhje të parakohshme, ndërsa kriza politike në vendin e tij thellohet, ditë pasi udhëheqësi i opozitës e shpalli veten president të përkohshëm. Në një intervistë për CNN-in turk që u transmetua të dielën, Maduro e hodhi poshtë ultimatumin e disa vendeve evropiane për të mbajtur zgjedhje brenda tetë ditësh ose përndryshe do njihnin si president kreun e opozitës, Juan Guaido. "Duhet ta tërheqim ultimatumin. Askush nuk mund të na japë ultimatum", tha Maduro në intervistën e dubluar në turqisht nga spanjishtja. Të shtunën, sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo i kërkoi bashkësisë ndërkombëtare të mbështeste popullin e Venezuelës dhe të njohë qeverinë e përkohshme të Juan Guaidosë. Diplomati më i lartë i Shteteve të Bashkuara tha në një takim të Këshillit të Sigurimit të shtunën se gjendja humanitare në Venezuelë duhet të adresohet menjëherë. "Ne jemi këtu për t'i nxitur të gjitha vendet që të mbështesin aspiratat demokratike të popullit venezuelian, ndërsa ai përpiqet të çlirojë veten nga shteti i paligjshëm mafioz i Presidentit Maduro. Situata humanitare kërkon veprim tani. Ajo kërkon veprim sot".

qishme nisën të mërkurën në mbrëmje dhe kanë shkakuar mjaft dëme në ndërtesa, automjete dhe zona bujqësore nëpër provincë. Sipas Agjencisë së lajmeve "Anadolu" në rajonin e Antalias humben jetën dy persona.

**SPANJË, TJETËR VIKTIMË GJENDET BRENDË NJË PUSI**



FOTOLAJM

As dy ditë nga humbja e jetës së 2-vjeçarit, Julen Rosello pas rënies brenda një pusi, një tjetër rast i ngjashëm goditi sërish Spanjën jugore, ku trupi i një 45-vjeçari u gjet i vdekur në fund të një pusi tjetër. Njeriu i paidentifikuar u largua nga shtëpia rreth orës 12 për një shëtitje me qenin e tij në kodrat e Villanueva del Trabuco në Malaga, në Spanjën jugore. Burri u gjet i vdekur, duke lundruar në ujë në një pus të thellë tre metra, rreth orës 3 të mëngjesit të së hënës, raporton "ABC Spain".

PËRVJETORI

# ISMAIL QEMALI

## Sendet që la pas arkitekti i pavarësisë

Fatmira Nikolli

Sendet vetjake, flamuri i tavolinës dhe gota e ujit, objekte nga fondi i Muzeut Historik Kombëtar, pena me të cilën u firmos Akti i Pavarësisë së Shqipërisë, aparati telegrafik i përdoruar nga Qeveria e Vlorës, një flamur i vitit 1913, gazeta të vitit 1912, si edhe libra dedikuar Ismail Qemalit.

Në përkujtim të 100-vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit, arkitektit të Pavarësisë, Muzeu Historik Kombëtar çeli ekspozitën dhe organizoi tryezën e rrumbullakët me titull "Rrugëtim - Ismail Qemali ndër vite".

Ekspozita u realizua për të kujtuar kontributin e tij të paçmuar për kombin shqiptar. E konceptuar si një rrugëtim i jetës së Ismail Qemalit (Vlorës), gjatë gjithë veprimtarisë së tij në administratën shtetërore, ajo nxjerr në pah një njeri me ide liberale dhe reformatore.

Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, tha se: "Ismail Qemali u dallua si frymëzues dhe organizator i kryengritjeve kundërosmane të viteve 1910-1912. Me veprimtarinë e tij të gjithanshme politike e diplomatike, Ismail Qemali u radhit ndër personalitetet më të përparuar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fillimin e shek. XX. Atdhedashuria dhe kontributi i tij në çështjen shqiptare, e ngrenë Ismail Qemalin në krye të figurave tona kombëtare, krahas asaj të Skënderbeut".

Në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Endrit Musaj, tha se "do të vazhdojë bashkëpunimi mes dy institucioneve sikurse ishte dhe gjatë Vitit Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut". Më tej, u mbajt një tryezë e rrumbullakët shkencore që u fokusua në rolin dhe veprimtarinë e Ismail Qemal Vlorës në çështjen shqiptare. Ligjëruesit në Tryezën Shkencore ishin: Dr. Dorian Koçi-Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Ardit Bido-Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Dr. Paulin Marku -Akademia e Studimeve Albanologjike, Prof. Dr. Frederik Stamati dhe Dr. Ariola Prifti.

Koçi tha se "Konferenca i bashkëgjitet ekspozitës "Rrugëtim - Ismail Qemali ndër vite" është një ndër aktivitetet e para të këtij viti.

*Përkujtohet 100-vjetori i vdekjes, ekspozitë dhe referate studimore për plakun e urtë*



Në kumtesën "Rrëfimi i periudhave historike të Ismail Qemalit përmes objekteve të tij në Muzeun Historik Kombëtar" drejtori Koçi trajton pjesën më të ndritur të historisë së kombit shqiptar, parë nga përshkrimi i disa objekteve origjinale të asaj periudhe, pjesë e fondi të Muzeut Historik Kombëtar". Dr. Paulin Marku referoi mbi "Rolin e Ismail Qemalit në memorandumin e Greçës" ku qëllimi kryesor ishte autonomia dhe pavarësia e Shqipërisë. Ndërsa në emër të Ardit Bidos, drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, u tha se: "Dokumentet të cilat ndodhen në Arkivin Qendror të Shtetit tregojnë për përpjekjet e njohjes së pavarësisë së Shqipërisë si dhe një

fond personal me dorëshkrimet fotot dhe kartvizitën e Ismail Qemalit".

Prof. Dr. Frederik Stamati dhe Dr. Ariola Prifti referuan mbi temën "Identifikimi i flamurit të Ismail Qemalit" ku qëllimi është studimi i epokave të ndryshme etnografike, pjesë e këtyre studimeve ishte dhe flamuri i Ismail Qemalit". Ekspozita "Rrugëtim - Ismail Qemali ndër vite" u organizua nga Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Qendrën Mbarëkombëtare të Koleksioneve Shqiptare dhe Bibliotekën Kombëtare.

Të pranishëm në këtë ekspozitë ishin të ftuar të ndryshëm si dhe

nxënës nga shkolla e mesme "Ismail Qemali" në Tiranë.


### HISTORIA E NJË FLAMURI

Për flamurin, me të cilin u varros Ismail Qemali është shkruar disa herë thanë dje Stamati e Prifti, duke e nisur që nga fakti se në deklarimet e Et'hem bej Vlorës bërë më datën 28 Vjeshtë e Tretë 1932, rezultoi se ai flamur ka qenë ngritur nga Ismail Qemali me 28 nëntor 1912 për shpalljen e Pavarësisë. Por sipas hetimeve të bëra nga prefektura e Vlorës ka rezultuar se ai flamur ka qenë ngritur vetëm në ndërtesën e doganës së Vlorës. Atëherë Et'hem bej Vlorës dha disa shpjegime për historinë e flamurit. Ndër të tjera, tha se atë "ia fali Duku i Montpansierit... nga Marsi i vitit 1913". Se si është historia del më qartë nga raporti i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lajhnc, bërë për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchold më 31 mars 1913. Në raport, sipas studiuesve Frederik Stamati dhe Ariola Prifti, që janë marrë me çështjen e flamurit, jepen detajet si vijon.

"Vlorë, më 31 mars 1913

...Lartësia e tij mbretërore, Ferdinand Franc Duka i Montpansierit erdhi këtu më 28 të k. m. natën vonë prej Korfuizit me jotin e vet ("Mekong"). Në shoqërimin e tij ndodheshin ish pretendenti i fronit shqiptar, princ Gjika dhe dy shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut: Mark Kakariqi një katolik i ri prej Shkodrës dhe Petër Goxhamani, një kucovllah ortodoks prej Beratit. Të tre personat e fundit kishin marrë pjesë në kongresin e shqiptarëve që u mbajt në Trieste në fillim të këtij muaji.

Me ndërmjetësinë e të dy shqiptarëve të sipërpërmendur, duka hyri në kontakt qysh në atë



Sipas hetimeve të bëra nga prefektura e Vlorës ka rezultuar se ai flamur ka qenë ngritur vetëm në ndërtesën e doganës së Vlorës. Atëherë Et'hem bej Vlorës dha disa shpjegime për historinë e flamurit. Ndër të tjera, tha se atë "ia fali Duku i Montpansierit... nga Marsi i vitit 1913".

mbrëmje me Ismail Qemal beun, dhe pastaj midis tyre u vazhdua një komunikim i shpeshtë. Të nesërmen, të shtunën, më 29 të k.m. Ismail Qemal beu së bashku me të dy të bijtë e tij, Et'hem dhe Qazim beun ishte ftuar për mëngjes në bordin e jahtit.

Gjatë pasdreses, duka, i veshur me uniformë oficeri të marinës angleze, i shoqëruar prej princit Gjika, kapitenit të vaborit dhe





mjekut të vaborit i bëri atij një vizitë. Mbasi u tha se duka kishte ndër mend që të qëndronte afërsisht një javë në Vlorë, shfaqën dëshirën edhe kolegu im italian dhe unë që t'i bënim një vizitë, e cila na u akordua. Konsulli i nderit i Rusisë, zoti Çika nuk mori pjesë në këtë vizitë, duke vënë si pretekst se nuk kishte instruksione dhe se ishte njoftuar me vonë.

Gjatë qëndrimit të tij këtu, Duka u tregua i afrueshëm, jo vetëm kundrejt autoriteteve zyrtare, por edhe kundrejt popullit, dhe në jaht u ftuan për të bërë vizitë, jo vetëm bejlerë të ndryshëm dhe ministra, por edhe njerëz të popullit, të cilët u pritën miqësisht në bord. Interesimin e tij të veçantë për Shqipërinë duka e shfaqti duke varur në direkun e përparshëm të jahtit flamurin e Shqipërisë, duke i falur qeverisë dy flamurë të barabartë, prej të cilëve njëri u ngrit menjëherë në zyrën e doganës dhe tjetri në zyrën sanitare të skelës. Pastaj u shpërnda edhe një sasi e madhe me fotografi të ndryshme dhe atë të tinë. Këto të fundit kishin një nënshkrim në gjuhën shqipe. Për të vobektët e Vlorës ai dhuroi një shumë prej 1000 fran-

ga, dhe pastaj ai lejoi të shpallej se për shqiptarët që vuanin nga uria ai ka ndër mend që të dërgojë një vapor me sende ushqimore, porse për shkak të bllokadës kishte qenë i detyruar që të hiqte dorë.

Të gjitha këto veprime të dukës së Montpensisë të lejojnë të kuptosh se ai do që të kërkojë fronin shqiptar. Hapi i tij gjykohej në mënyrë të ndryshme, herë si i guximshëm dhe i urtë, herë si aventuresk dhe jo i urtë. Bëhet pyetja: Kush do të jetë prapa kësaj kandidature? Duke marrë parasysh disa rrethana shoqëruese, këtu jemi të dispozuar të besojmë, se këta mund të jenë Tripëlantanta dhe Lidhja Ballkanike."

Cituar nga: "Haus-Hof und Staatsarchiv, Wien, Politisches Archiv (më tej HHSPA), në Arkivin e Institutit të Historisë, (më tej AIH), Vj 23-17-1701, Raporti i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lajhnc për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchold, Vlorë, 31 mars 1913".

Autorët e studimit falënderuan historianen Ledia Dushku, që u vuri në dispozicion këtë dokument dhe shtuan se në dokumentin e përkthyer janë bërë disa ndreqje gjuhësore,

**T**eoritë e ndryshme mbi totalitarizmin e përkufi zojnë atë si një regjim politik antidemokratik, pa parlamentarizëm, me një parti - të vetme, në të cilin "individit dhe shoqëria i përkisnin shtetit, i konsideruar jo vetëm si një entitet moral e shpirtëror i aftë që të përfaqësonte kombin, por edhe që të asimilonte totalisht degëzimet e ndryshme të shoqërisë civile". E thënë më qartë, veçoria më e rëndësishme e regjimeve totalitare është kontrolli i plotë dhe i detajuar i të gjithë ideve, besimeve dhe shprehjeve. Regjimet totalitare kërkojnë, pra të krijojnë një shtet të uniformizuar dhe të sigurojnë nga shoqëria bindjen e verbër kundrejt pushtetit. Arritja e uniformitetit të skajshëm është tejet sfiduese për sa kohë që shoqëria njerëzore përmbledh njerëz me individualitete, pikëpamje, bindje dhe besime të ndryshme. Regjimit totalitar i duhet të sigurojë bindjen e shumicës dhe të frikësorë apo/dhe eliminonjë me mjete e forma të ndryshme atë pakicë të padëshirueshme, e cila mund të bëhet pengesë për lider-shipin. Në këtë proces, dhuna e ushtruar nëpërmjet institucioneve të posaçme (shërbimi i fshhtë, burgjet, internimet, puna e detyruar) dhe propaganda e imponuar, sa nga mediet e kontrolluara nga shteti, aq edhe nga organizatat e masave, janë dy shtyllat kyçe të cilat sigurojnë jetëgjatësinë e një regjimi diktatorial. Në një farë mënyre, regjimi ka nevojë për figurën e "armikut të popullit", i cili herë vizatohet si individ që rrezikon mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë e herë si "tradhtari" që luan me pavarësinë e sovranitetin e shtetit. Regjimi i vendosur në Shqipëri e filloi jetën që në gjenëzë si një regjim totalitar, i bazuar në modelin e shtetit sov-

## "FYTYRA E 'ARMIKUT TË POPULLIT' NË NJË KONFERENCË SHKENCORE



jetik të drejtuar nga Stalini, qeverisja e re e PKSH u bazua në të njëjtat metoda dhe metodologji. Të gjithë ata që kanë jetuar gjatë viteve të "diktaturës së proletariatit" në Shqipëri janë ushqyer ditë pas dite me konceptin e "armikut të popullit". Regjimi nuk e fshihte që "diktatura e proletariatit" ishte në thelb "dhunë e shumicës ndaj një pakice të privilegjuar". Ky slogan përlligjte jo vetëm dhunën e ushtruar ndaj kundërshtarëve politikë realë apo imagjinarë, por edhe krijonte kohezionin e nevojshëm publik, i cili do t'i shërbente jetësimin të pushtetit të drejtuesve të PKSH/PPSH. Qëllimi i kësaj konference është të sjellë në vëmendje dhe të hapë një debat shumëdisiplinor shkencor e publik mbi mekanizmat që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar hendekun ndërmjet kundërshtarëve politikë realë, apo potencialë me pjesën tjetër të popullsisë; ti-pologjinë e "armiqve të popullit". Autoriteti për informim mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojavë të Komunizmit ftojnë të para-

qiten propozimet për prezantime për konferencën "Fytyra e 'armikut të popullit' gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri (1944-1990)", e cila do të mbahet më 17 maj 2019 në Tiranë. Konferenca do të përqendrohet në këto tematika kryesore: 1. Diskutim teorik mbi konceptet disidentë, disident, kundërshtar politik; 2. Kontribut mbi debatin: A ka pasur disidentë në Shqipëri?; 3. Ngjashmëri dhe dallime në vizatimin e "armikut të popullit" midis Shqipërisë dhe regjimeve të tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore; 4. Tipologjia e "armikut të popullit" dhe sjelljes së regjimit ndaj tyre ("kriminelët e luftës", kleri, intelektualët e shkolluar në Perëndim, tregtarët dhe pronarët, kulakët, "armiku i popullit" brenda radhëve të Frontit Demokratik dhe PKSH/PPSH); 5. Evolucionin e konceptit "armiku i popullit" gjatë viteve të diktaturës së proletariatit; 6. Lufta e klasave dhe ndryshimet në konceptimin e saj përgjatë regjimit; 7. Sigurimi i Shtetit si instrument përndjekjeje dhe 8. Profile të ndryshme të "armikut të popullit".

## ZAMIR MATI: IDEJA I PULLËS POSTARE ME SKËNDERBEUN NË FRANCË

**E** gjitha ka nisur me ek-spozitën me temë "Gjergj Kastriotin Skënderbeun përpara tri vitesh". Atëherë u shpall-sën 32 punime të 17 autorëve dhe midis tyre edhe piktorë të Kosovës. Mes të tjerash, piktori i Merituar Zamir Mati, pati prezantuar projektin e dekorimit të sheshit 'Skanderbeg' në Paris. "Një skulpturë dekorative në siluetë të prerë me lazer të një grup kalorëshish të Heroit tonë kombëtar që nisen drejt Europës. Pikërisht kjo është ideja që është pasqyruar edhe në pullën e postës e cila së shpejti del në qarkullim. Është një vizatim (fragment), i cili tregon Skënderbeun", tha dje Mati për "Gazeta Shqiptare". Sipas tij ideja disa vjeçare e dekorimit të sheshit ka kërkuar punë krijuese dhe një mbështetje prej La Maison de l'Albanie duke e realizuar atë në materiale dhe dimensionet e ndryshme. "Në përfundim të këtij projekti bën pjesë edhe botimi i një pullë poste nga La Poste Françë, botim i propo-



zuar prej La Maison de l'Albanie.

Së shpejti kjo shtëpizë e vockël e Shqipërisë do të bëjë edhe promovimin e pullës postare me figurën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut në hapësirën e saj 26 place Denfert Rochereau Paris 14.

"Maison d'Albanie" është një qendër kulturore, e cila ka gjashtë vite që zhvillon aktivitetet të ndry-

shme në Espace 26, Place Denfert Rochereau, Paris 14. "Maison d'Albanie" është pranuar së fundi me të drejta të plota në FICER, një rrjet ku përfshihen mbi pesëdhjetë qendra kulturore, të cilat vepronjnë në Francë, e midis tyre Instituti i kulturës 'Gëte' të Gjermanisë, 'Servantes' të Spanjës, të Italisë, Austrisë etj. "Maison d'Albanie" ka një këshill drejtues të përbërë nga Agron Hasku, profesor i gjuhës frënge në universitetin e Parisit, Luan Rama shkriktar, Gjergji Leka fizikant dhe studentes i gjuhëve të lashta europiane, Zamir Mati piktor dhe Gjergji Themeli drejtues i 'Albinos' dhe president i kësaj qendre kulturore. Në këtë 'Espace', e cila ndodhet në një nga sheshet më kryesore të Parisit dhe që në qendër të tij ngrihet madhështore skulptura e Luanit të Belfortit, simbol i mbrojtjes së Francës, veprë e realizuar nga skulptori August Bertoldi, i njëjti autor, i cili ka realizuar statujtën e "Lirisë" në New-York.

Opinion i Ditës

# Pse duhet privatizuar radiotelevizioni shtetëror

Nga Adri Nurelari

(villon nga faqja 1)

... konkurrojnë fare mirë me vende më të zhvilluara. Mirëpo ndërkohë që kemi një treg të pasur privat, vazhdojmë që të mbajmë në mënyrë të pa-nevojshme radiotelevizionet shtetërore të financuara nga paratë e taksapaguesve. Ka ardhur koha që të hapim një debat serioz për të privatizuar radio televizionet shtetërore gjë që deri tani është konsideruar një tabu për debatin publik në Kosovë dhe Shqipëri. Mungesa e këtij debati është një dëshmi e qartë se sa të prapambetur jemi ne për sa i përket kufizimit të rolit të shtetit në ekonomi dhe nevojën për të çliruar hapësirën mediatike në favor të tregut dhe konkurrencës.

Duhet kuptuar që radiotelevizionet shtetërore janë ndërtuar në një epokë kur investimi ishte i përmasave të jashtëzakonshme, sepse teknologjia ishte e shtrenjtë e po ashtu aspekti teknik me antena e pajisje të shumta e bënte shumë të lartë koston e hyrjes në tregun e medias elektronike. Kur është krijuar BBC, 96 vite më përpara, ka pasur teknologji dhe ekonomi krejt ndryshe nga sot dhe vetëm shteti kishte mundësi e vullnet që ta ndërtonte atë televizion asokohe. E njëjta gjë ndodhte në atë kohë me telefoninë. Por më pas tregu u hap, teknologjia evoluoi dhe shtetit iu desh të bënte një hap prapa. Sot kompanitë telefonike janë pothuaj kudo private, me avantazhe të dukshme në cilësinë e shërbimit, në koston më të ulta për konsumatorët si dhe në shumëllojshmërinë e ofertës. Edhe interneti fillimisht është krijuar me përfshirje të qeverisë amerikane, por pjesa më madhe zhvillimit të këtij rrjeti global dhe pasurimi i tij me përmbajtje më pas u bë pa parur nevojë për dollarët e taksapaguesve amerikanë.

Mediat elektronike në epokën e sotshme nuk kanë më nevojë për para nga shteti, përderisa qoftë në Kosovë e qoftë në Shqipëri kemi një treg të lulëzuar pluralist televizivësh e radios private që sa vijnë e konsolidohen e pasurojnë programacionin. Sot kemi dhjetëra kanale televizive vendas informativë qendrorë e lokalë, e dhjetëra të tjerë kabllorë apo satelitorë që e bëjnë njësoj ose më mirë punën që bënin sot RTSH apo RTK, pa futur duart në xhepat tonë. Një ndër parimet thelbësore të ekonomisë së tregut është që qeveria duhet të përdori paratë e mbledhura nga djersa e taksapaguesve vetëm për të financuar shërbime apo të mira publike, të cilat përndryshe nuk



do të ekzistonin, sepse bimirësia apo sektori privat s'do kishin leverti për t'i financuar.

Argumenti kryesor që përdoret për të justifikuar ekzistencën e televizionit të paguar prej buxhetit është çështja e programacionit, dhe nevoja për të pasur një rol të theksuar kulturor dhe edukativ. Mirëpo këtë nevojë fare lehtë mund ta përmbushim duke e vendosur si rregull të detyrueshëm edhe për televizionet private që të transmetojnë medoemos një përqindje të caktuar të programacionit për çështje edukative apo kulturore si kusht për të rinovuar licencën. Kjo praktikë tashmë është pjesë e direktivave të Bashkimit Evropian e eventualisht, herët a vonë, do i përqafojmë edhe ne. Fundja nëse qeverisë i duhet që të promovojë një çështje apo të përhapë një lajm me rëndësi shtetërore, atëherë për atë rast le të paguajë në mediat kryesore kohë transmetimi. Ashtu sikurse shteti paguan kompani private për të ndërtuar infrastrukturën le të paguajë edhe media private për të promovuar çështje të interesit publik sikurse mund të jetë ta zëmë një fushatë për ndonjë epidemi. S'ka pse të mbajmë dinosaurë të mëdhenj në këmbë me taksat e popullit vetëm për këto nevoja të rralla e rastësore që mund të përmbushen nëpërmjet operatorëve privatë me një kosto shumë të ulët për taksapaguesin.

Një tjetër argument që përdoret për të justifikuar ekzistencën e radio-televizioneve shtetërore është pretendimi se i japin hapësirë segmenteve të neglizhuara të shoqërisë. Mirëpo tanimë nuk ka ndonjë rrezik që të ngelen zëra apo segmente të përfaqësuara e të patransmetuara në këtë epokë të teknologjisë së informacionit. Sot

me përhapjen masive e kapilare të internetit, qytetarët kanë nëpërdur të tyre burime të pakufizuara informacionesh të gjitha ngjyrave. Mjafton një telefon i mençur e ca njohuri teknike themelore për internetin që çdo kusht të ketë qasje me profilin e tij në rrjetet sociale tek një audiencë globale prej qindra milionash.

Mbi të gjitha nevoja për privatizim është diçka parimore. Media duhet të jetë e shkëputur nga politika në përgjithësi dhe nga qeveria në veçanti. Ne presim nga media që të luajë rolin e rojtarit (watchdog) dhe vënësist përpara përgjegjësisë të qeverisë dhe institucioneve shtetërore për keqfunksionimin e tyre apo për abuzime e shpërdorime ndërkohë që njëherazi kemi një media shtetërore. Me pak fjalë shteti apo qeveria janë pala e dyshuar, versioni i tyre duhet marrë me rezervë e verifikuar, sepse kanë interesa që nuk përputhen detyrimisht me interesat e publikut. Kur qeveria na sjell lajmin me të gjitha paragjykimet, përpunimet e rrotullimet e pashmangshme që do të ketë ky lajm, qeveria faktikisht po e vendos gishtin e saj në peshoren e shenjtë të demokracisë që është media. Prandaj, idealja do të ishte që gazetarët të mos punojnë për shtetin dhe taksapaguesit të mos detyrohen të subvencionojnë lajmet dhe programet e qeverisë që shpesh rezultojnë në propagandë.

Prandaj në parim ne nuk duhet të tregohemi entuziast për një media shtetërore si burim informacioni për publikun, sidomos kur e dimë që ka boll kanale të tjera për të informuar publikun. Në të njëjtën mënyrë sikurse prej kohësh kemi hequr dorë nga publikimi i një gazete komëtare nga sh-

teti, ashtu duhet të heqim dorë nga një media elektronike shtetërore e aq më tepër nga një agjenci lajmesh shtetërore. Në një shoqëri të liberal-demokracisë, informacioni, argëtimi dhe kultura mund të jenë vetëm private, sepse nuk ka liri të shprehjes jashtë tregut të lirë. Ndërsa RTK ia ka dalë të mbajë një dimension më të lartë të etikës së punës dhe profesionalizmit çka e dëshmon vetë përqindja e lartë e shikueshmërisë e besueshmërisë që ka në publik, RTSH është thjesht një instrument propagande i mazhorancës cilado qoftë ajo. Kjo do të thotë që linja redaksionale reflektonte kompozimin e parlamentet në atë legjislaturë.

Situata është akoma më absurde në Shqipëri ku shteti jo vetëm ka një medium elektronik, por ka edhe një agjenci lajmesh me buxhet të majmë me vete që quhet Agjencia Telegrafike Shqiptare. Këto agjenci shtetërore të informacionit si ATSH e Shqipërisë, Tanjue e Serbisë, Itar-Tass e Rosisë, Xinhua e Kinës e të tjera të ngjashme, janë mbeturina të komunizmit, të një epoke ku informacioni filtrohej e censurohej nga qeveria e propaganda përpunohej e shtejë si lajm tek qytetarët e robëruar. Më përpara informacioni që dilte nga këto agjenci shtetërore informacioni konsiderohej si qëndrim zyrtar i shtetit mirëpo sot që institucionet shtetërore kanë zëdhënësit e vet të shtypit, zyra të komunikimit, faqe interneti e rrjete sociale, nuk shkon më njeri tek agjencitë shtetërore për të marrë qëndrimet shtetërore. Faktikisht pothuaj asnjë media në Shqipëri nuk i referohet ATSh-së për lajmet e para që dalin, dhe taksapaguesit vazhdojnë ende që të paguajnë për ekzistencën e këtij relikti historik, vetëm e vetëm se parti të në pushtet e kanë përdorur si strehë punë-

simi për të shpërblyer militantët e zellshëm.

Një tjetër shkak përse duhen privatizuar kanalet shtetërore është për të shmangur deformimi që i bëjnë ata tregut. Konkretisht prania e tyre ka një efekt shtrembërues për peizazhin mediatik në vend pasi këto kanale nuk janë të ekspozuar ndaj tregut dhe për rrjedhojë janë më pak të përgjegjshme ndaj kërkesave të konsumatorëve të medias. Po ashtu duke qenë të subvencionuara nga paratë tona këto media përbëjnë një konkurrencë të pandershme për kompanitë mediatike private të cilat, në rrethana të tjera do të ishin më të konsoliduara e më të suksesshme po mos të kishin konkurrencë nga mediat shtetërore. Rasti më tipik është efekti dumping që ka në krahun e punës së gazetarëve në Kosovë ku RTK ofron rroga shumë më të mira sesa sektori privat duke bërë që këto televizione private të kenë hemorragji të vazhdueshme sa herë hapen vende të reja në RTK. Pra, si argumente në favor të privatizimit të RTSH dhe RTK duhen patuar parasysh argumentet ekonomikë që janë përmbushja e kënaqësisë dhe interesave të konsumatorit, eliminimi subvencioneve të taksapaguesve dhe siguri mi i një konkurrence neutrale në tregjet mediatike.

Ne sot faktikisht nuk kemi luksin që të kemi një televizion publik. Kemi një borxh publik në rritje e deficit buxhetor në thellim në të dy shtetet e banuara nga shqiptarët. Vështirë se do ia dalim ndonjëherë që ta shlyejmë atë borxh apo ndalim deficitin nëse nuk fillojmë të ulim shpenzimet buxhetore jo thelbësore sikurse janë mediat elektronike shtetërore apo akoma më keq agjencia telegrafike shqiptare. Buxheti i RTK-së për shembull financohet nga buxheti i qeverisë me shumën 0.7% që me buxhetin e ri prej 2 miliardësh përkehtet në 14 milionë euro për një shërbim publik të pa-nevojshëm e të padobishëm që dëmton tregun mediatik. Veç mund të imagjinohet kostoja oportune e përvitshme për shoqërinë e gjithë këtyre parave të cuara dëm po të ishin shpenzuar në arsim, shëndetësi, shkencë, sport e kulturë. Me gjithë këto para të harxhuara kot gjatë gjithë këtyre viteve mund të ishin ndërtuar tashmë salla koncertale, arena festivesh, stadime të reja, pallat të mbyllur të sporteve, muze të shkencës, parqe zoologjik e botanikë etj. etj. që i mungojnë aq shumë Kosovës. Prandaj për të gjitha këto arsye ne kemi nevojë që ta marrim në konsideratë seriozisht idenë e privatizimit të radiotelevizioneve shtetërore.

Mesazhi i Ditës

# Kushtet e mia që Kosova të heqë "taksën" me Serbinë

Nga Ramush Haradinaj

(vijon nga faqja 1)

... Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën nr. 64/298 (2010), e cila njohu përmbajtjen e Opinionit të GJND-së dhe mirëpriti "gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet palëve".

Ne kemi bindje të thellë që mund të arrihet në vitin 2019 një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht e detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila do t'i adresojë të gjitha çështjet e pazgjidhura, duke përfshirë reparacionet e luftës, të drejtat e minoriteteve në të dyja vendet, si dhe çështjet e ndryshme ekonomike, sociale dhe kulturore - duke çuar në njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Më 21 nëntor 2018, Qeveria e Kosovës vendosi një taksë prej 100% ('taksë') mbi importin e mallrave me origjinë nga Serbia si dhe nga Bosnja dhe Hercegovina.

Taksa ka ardhur si përgjigje ndaj shkeljeve të vazhdueshme të Marrëveshjes për Tregtinë të Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) dhe akteve të vazhdueshme të

agresionit që kanë për qëllim dëmtimin e shtetit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të pezullojë menjëherë tarifën në rast se plotësohen rrethanat e mëposhtme:

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Bashkimi Evropian (BE), pas marrjes së hapave praktik për iniciimin dhe mbështetjen e një konference ndërkombëtare ("Konferenca") me qëllim të arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të pazgjidhura ndërmjet dy vendeve - konferenca duhet të fillojë sa më parë që është e mundur pas plotësimit të rrethanave të përshkruara në paragrafët 2 deri në 5 më poshtë dhe duhet të përfundojë brenda 14



ditëve:

2. SHBA-të dhe BE-ja do të japin zotime publike dhe do të garantojnë që në konferencë nuk do të ketë:

- (i) Çfarëdo rivendosje të kufijve ekzistues të Kosovës, ose ndarje të Kosovës, ose shkëmbime territoriale të çfarëdo natyre.
  - (ii) Dhënie të kompetencave ekzekutive të çfarëdo forme për asociacionin e komunave serbe në Kosovë ose ndonjë marrëveshje tjetër që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.
  - (iii) Masa të çfarëdo natyre të bazuar në koncesione që shkojnë para datës 17 shkurt 2008.
3. BE-ja do të japë zotime shtesë publike dhe do të garanton se:

(i) Do të hyj në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës para fillimit të konferencës.

(ii) Do të zbatohet dhe do të jetë plotësisht funksionale Marrëveshja për Energji e arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë para fillimit të Konferencës.

4. Është verifikuar se Serbia ka larguar të gjitha barrierat jotarifore të shkaktuara ndaj lëvizjes së mallrave nga Kosova, si dhe të gjitha kufizimeve të paligjshme në tregtinë e shërbimeve dhe lëvizjen e njerëzve nga Kosova në Serbi.

5. Presidenti, kryeministri ose ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë konfirmojnë publikisht se janë ndaluar në mënyrë perma-

nente të gjitha politikat dhe veprimet e çfarëdo lloji të drejtuara kundër aspiratave të Kosovës si shtet sovran, qoftë nëse ato aplikohen në nivel lokal, rajonal apo ndërkombëtar.

Tarifa do të rivendoset menjëherë nëse konferenca nuk përfundon me një marrëveshje gjithëpërfshirëse të detyrueshme mes Kosovës dhe Serbisë, e cila siguron, ndër të tjera, njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Tarifa do të rivendoset në një datë të mëvonshme nëse nuk arrihet të zbatohet marrëveshja gjithëpërfshirëse e detyrueshme e arritur në konferencë.

## HOROSKOPI

### DASHI

Këtë të martë do të keni mundësi të pushtoni paksa. Në punë nuk do të jeni të ngarkuar si zakonisht. Do të qëndroni nën praninë e familjarëve tuaj, çfarë do t'ju kënaqë pamasë. Ka gjasa që sot ta shkëlqen dietën ushqimore, megjithatë është e tolerueshme nëse nuk e teproni.

### DEMI

Mund të keni fat në një lotari. Megjithatë mos rrezikoni duke kaluar limitet. Financat, dashuria dhe karriera do të kërkojnë balancim dhe ndërmarrjen e hapave seriozë. Mos u mbështetni vetëm tek të tjerët për të zgjidhur problemet tuaja.

### BINJAKET

Binjakët i kanë të gjitha shanset për ta kaluar 29 janarin qetësisht. Do të mendoni shumë rreth marrëdhënies suaj në dashuri dhe do përpigjeni të merrni një vendim. Mos u bëni pjesë e thashethemeve, pasi ka gjasa të përfshiheni në një konflikt.

### GAFORJA

Në jetën e Gaforreve sot mund të ngrihet një çështje e rëndësishme. Ka mundësi që do t'ju duhet të zgjidhni mes profesionit, të ardhmes në familje ose do t'ju duhet të mendoni seriozisht për shtëpinë. E gjitha kjo situatë do t'ju lodhë shumë psikologjikisht.

### LUANI

Disa Luanë do të kenë dëshirë të bëjnë aventura. Çdo hap që do të ndërmerri apo çdo fjalë që do të thoni, mendojni mirë. Shmangni takimet e dyshimta apo përfshirjen në një marrëdhënie të dyshimta. Mos u përfshini në gjera jo personale.

### VIRGJERESHA

Virgjreshat duhet të zhvillojnë shumë takime. Ka gjasa të kontaktoni me një specialist shumë të mirë. Sa i përket jetës personale, mund të përjetoni një moment të pakëndshëm partnerin/partneren tuaj. Vëmendja që ai/ajo do t'ju kushtojë do të jetë minimale.

### PESHORJA

Peshoret mund të kenë edhe sjellje ekstreme gjatë ditës së sotme. Mund të doni të nisni një çështje profesionale me shpejtësi, por më pas nuk do e keni më këtë dëshirë. Kjo tregon sesa të luhatur do të jeni gjatë ditës së sotme. Përpiguni të rribani veten nën kontroll dhe sillni me seriozitet sa më shpejtë të jetë e mundur.

### AKREPI

Disa Akrepë do të kenë një ide rreth mënyrës sesi mund të ndryshojë jeta e tyre. Mos i merrni menjëherë për bazë këto mendime. Është e rëndësishme që nëse keni ndërmend të merrni ndonjë vendim, mendoni një plan strikt.

### SHIGJETARI

Shigjetarët do të kenë fat në marrëdhëniet e tyre personale. Mund të nisni një marrëdhënie të re romantike, por ekziston edhe mundësia për t'iu rikthyer lidhjes suaj të vjetër. Sa i përket anës profesionale, do të jetë një ditë rutine.

### BRICJAPI

Përpiguni të korrigjoni gabimet dhe të largoni konfuzionin në jetën tuaj personale. Duhet, gjithashtu, të kujtoni sesa e rëndësishme është të kënaqësh të tjerët. Bëni kujdes të mos i ktheheni një konflikti të vjetër.

### UJORI

Ujorët duhet t'i kontrollojnë me kujdes mendimet e tyre. Shmangni pesimizmin dhe kritikën e shumta ndaj të tjerëve. Kushtojni vëmendje partnerit/partneres suaj, por mos neglizhoni as familjarët. Në fund të ditës mund t'ju vijë një surprizë e këndshme.

### PESHQIT

Do të keni një ditë të ngarkuar në punë. Edhe pse do të lodhni shumë, ka gjasa të mos arrini rezultatet që dëshironi. Sa i përket jetës personale, do të përjetoni një atmosferë krejtësisht ndryshe. Është dita e duhur për të shprehur ndjenjat tuaja.

FIRMOS QENDËRMBROJTËSI



Tirana siguron goleadorin e Erzenit, Jurgen Goxha

Kishte disa ditë në provë te Tirana, por më në fund ka bindur trajnerin Ardian Mema për aftësitë e tij. Klubi bardheblu ka zyrtarizuar afrimin e parë në merkaton e dimrit, Jurgen Goxha.

Mbrojtësi 26-vjeçar vjen nga ekipi i Erzenit në Kategorinë e Parë dhe do të jetë një forcë më shumë për Ardian Memën në repartin defensiv. Goxha ka firmosur për 1 vit e gjysmë me bardheblutë. Ai spikati

në pjesën e parë të sezonit në Kategorinë e Parë, teksa ishte dhe kryegolas-hënuesi i ekipit me 7 gola, shifër e konsiderueshme kjo për një qendërmbrojtës. Ndërkohë Tirana e kishte të nevojshme afrimin e një lojtari në këtë pozicion pas prishjes së kontratës me Sedat Berishën.

DRAMA E ARGJENTINAST



Trajneri i Sala: Mendova të lë futbollin

Drama e Emiliano Sala vijon të mbajë në ankth botën e futbollit. Pak orë përpara takimit kundër Arsenalit, është trajneri i Kardifit, Neil Uarnok, që ka folur për herë të parë që nga zhdukja e lojtarit argjentinas. "Trajnoj prej 40 vjetësh dhe ka qenë java më e vështirë gjatë gjithë karrierës sime. Nuk e kam provuar kurrë më parë një ndjesi të tillë. Natyrisht që e çova në mendim dhe të largohem nga bota e futbollit. Në këtë javë ka qenë mendimi im gjatë gjithë 24 orëve. Por kam një detyrim këtu, duhet të bëjmë një mrekulli", deklaroi Uarnok. Ndërkohë lojtarët e Kardifit po ndiqen prej ditësh nga një grup psikologësh, që po i ndihmon të përballojnë situatën. Edhe pse autoritet kanë shuar shpresat për gjetjen e 26-vjeçarit argjentinas, familja, e ndihmuar nga shumë futbollistë, ka financuar kërkimet me shpresë për të gjetur njeriun e shtrenjtë.

Ndërkohë Milani po bëhet gati të derdhë 40 milionë euro për mesfushorin Tiemue Bakajoko



Jeton Selimi

Gatuzo harron Higuainin: Piatek po më pëlqen shumë

Trajneri krahason polakun me danezin Tomanson

Milani ka hyrë në një epokë të re në sulm, ajo e polakut Kristof Piatek, që në përballjen e së shtunës kundër Napolit u aktivizua në pjesën e dytë të takimit. Piatek kaloi te kuqezinjët pas një aventure të shkëlqyer te Xhenova, ndërsa trajneri i Milanit, Xhenaro Gatuzo, ka vetëm fjalë të mira për të, duke e krahasuar me sulmuesin danez Jon Dahl Tomanson. "Jon nuk kursehej kurrë në stërvitje dhe na ndihmonte shumë edhe kur luante nga fillimi. Piatek ka mbërritur prej pak kohësh, por mua më pëlqen. Është një djalë kurioz, që shikon gjatë fotot në Milanelo. I pëlqen të vëzhgojë, të flasë e të jetojë me strukturën tonë. Kjo është gjë e bukur. A do të jetë titullar nesër? Do t'ua jap një mesazh dhe Kutrones.

KRITIKAT

23 vjeç e 276 ditë ishte mosha mesatare e titullarëve të Milanit në ndeshjen kundër Napolit. Rinia është elementi thelbësor për një ekip me ambicie të mëdha ku kapiteni Romanjoli sapa ka mbushur 24 vjeç. Pikërisht lideri i mbrojtjes së "Djallit" ka për-



funduar në shënjestrën e një mjeshtri si Arrigo Saki, i cili në një deklaratë për "La Gazzetta dello Sport" nuk ka

ngurrur të kritikojë për aspektin estetik. "Romanjoli është rritur më pak sesa pritej, por megjithatë i du-

het punë, pasi cilësitë nuk i mungojnë. I duhet të vendosë edhe nëse ka ftohtë ose jo. Nuk e kuptoj përse vesh

bluzë më mëngë të shkurtra dhe mban dorashka", shpjegoi Saki.


BAKAJOKO

Blerja përfundimtare e mesfushorit Tiemoue Bakajoko nga Çelsi është shumë afër. Sipas asaj që shkruan "Tuttosport", klubi kuqezinj është gati të derdhë shumën e 40 milionë eurove në arkën e klubit londinez, siç është parashikuar në akordin e arritur në verë. Paraqitja e mirë e mesfushorit në ndeshjet e fundit duket se i ka bindur drejtuesit e Milanit për ta mbyllur blerjen në fund të sezonit. Pas atij fillimi disi dyshues, Bakajoko është rritur shumë dhe e ka ndihmuar shumë skuadrën në lojën mbrojtëse, duke u bërë një element shumë i rëndësishëm në formacionin e trajnerit Gatuzo.

Trajneri i madh vë veton

Ferguson: Mesi është më i mirë se Maradona


Mesi apo Maradona? Cili është më i miri në botë? Cili prej tyre vështron nga lart tjetrin? Kjo është dilema e madhe ekzistenciale e futbollit modern, që ka hapur një debat mes tifozëve dhe specialistëve të futbollit. Të gjithë kanë të preferuarin e tyre. Dikush sheh si perëndinë e futbollit Maradonën, tjetri Mesin. Por ai që ka vendosur t'i vërë kapak kësaj dileme të madhe, është as më shumë e as më pak por Sër Aleks Ferguson. "Mesi është më i mirë sesa Maradona. Mesi është shumë herë më mirë sesa Maradona dhe ndryshe nga yjet e epokës së kaluar (Pele dhe Maradona), mbrojtësit janë shumë të organizuar dhe bëjnë gjithnjë e më shumë për të justifikuar rrogat e tyre të larta", ka thënë ish-trajneri i Manchester Junajtidit.



Por lë jashtë Realin

Guardiola: Ja 3 skuadrat më të mira të dekadës

Trajneri i Manchester Sitit, Pep Guardiola, është padyshim një nga ikonat e futbollit në dekadën e fundit dhe një nga trajnerët që ka fituar çdo kompeticion të mundshëm me Barcelonën e tij. Në një prononcim për mediat ishullore, trajneri katalanas ka listuar tri skuadrat më të mira të dhjetë viteve të fundit, duke lënë jashtë kësaj liste Realin e Madridit, që vetëm vitet e fundit ka siguruar tre Champions League. Sipas Guardiols, tri skuadrat më të mira janë Bajerni, Barcelona dhe Juventus, tri skuadra që nuk kanë reshur së fituari gjatë kësaj periudhe. Por deklarata e Guardiols nuk është mirëpritur në Spanjë. Mediat iberike nuk kanë ngurrur të vënë në lojë ish-trajnerin e Barcelonës, duke thënë se fakti që Reali është lënë jashtë kësaj liste, mund të jetë vetëm një lapsus.




Në Londër presin kroatin

Emeri: Perisiç është ideal për Arsenalin

Ndërsa vijon tratativa mes Interit dhe Arsenalit për Kralimin e kroatit Ivan Perisiç në Londër: Trajneri i "topçinjve", Unai Emery, del zbuluar gjatë konferencës për shtyp përpara ndeshjes ndaj Kardifit. "Klubi po punon që të afrojë disa lojtarë. Nuk ua di emrat, nuk mund t'ua them me saktësi se cilët janë, por bëhet fjalë për lojtarë që do të na ndihmojnë dhe që mund të luajnë si në krahun e majtë ashtu dhe në të djathtin. Perisiç? Mendoj se çdo lojtar që është në gjendje të na ndihmojë është i mirëseardhur". Pra, pas fjalëve të Marotës që konfirmuan faktin se kroatit kërkon të largohet nga zikaltrit që në këtë dritare merkatoje, kontaktet mes dy klubeve për gjetjen e gjuhës së përbashkët kanë hyrë në fazën vendimtare. Arsenali ka propozuar një huazim prej 4 milionë eurosh dhe 40 të tjera në verë për blerjen e plotë të kartonit. Zikaltrit janë dakord me shifrën, por jo me formulën, duke kërkuar që të vendosin në kontratë klauzolën "detyrim për blerjen e kartonit në fund të huazimit".

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Është pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Që harkëtar i famshëm i akeje.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërsës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Është anije me dy skafë.
- Fundi i Turandot.
- Iniciale e Reitman regjisor.
- Farell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

**VERTIKAL**

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Është njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Ditong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Është shpend lagune.
- Është operator që bën zoom.
- Është i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Është shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përhëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimin.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Është shkolla e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e markotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Është ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.

**VERTIKAL**


- Kufij takimi.
- Ekstremet e tokës.
- Iniciale e Einstein.
- Qendër mesimi.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vullkanesh
- Është edhe ai Persik.
- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agia.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Është borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Është fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Është ilon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

	8		6		3	1	9		
		1	5				2		
	4								7
			4	2		6			
									5
						9	6	7	8
2	1		9	4	8				3
			1						
					2	5	8		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	8	3	1	2	6	4	5	7	
6	5	1	3	7	4	8	9	2	
2	4	7	9	5	8	3	6	1	
5	9	8	4	1	2	6	7	3	
4	1	2	7	6	3	9	8	5	
7	3	6	5	8	9	1	2	4	
1	6	4	2	9	7	5	3	8	
8	7	5	6	3	1	2	4	9	
3	2	9	8	4	5	7	1	6	

*Argëtim filozofik*

-Mos mbivlerëso atë që ke marrë dhe mos lakmo tjetër: Ai që lakmon tjetër nuk do arrijë paqen e mendjes.

-Kjo udhë Ariane me 8 rrugë, dmth: vizion i drejtë, qëllim i drejtë, fjalë e drejtë, veprim i drejtë, jetë e drejtë, përpjekje e drejtë, vëmëndje e drejtë, meditim i drejtë.

-Katër të vërtetat fisnike: të lindësh, të jetosh, të vdesësh, të ringjallësh.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8		M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K		
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12		E	S	T	E	R		A		D	H	U	N	A	
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2			I	T	E	A	T	E	R		M	I	N		
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2				E	R	A		P	O	L	A	R		T	A		
4	8	6	5	2	15	8		7	15	10	7				K	E	L		P	O	L	E	M	I	K	A	T	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15			L	E	T	A		P	O	L	I	G	A	M	I	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7			E	T	A		P	I	K	A	T		R	E	L	
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6			K	O	M	O		D	E	N		T	O	K	E	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8			T	R	I		S	E	T	M		N	U	N		
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7				I	T		T	U	T	U		I	T	I	D		
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5				K	A	D	E	T		K	O	S	H	L	E		
																E	T	I	K		S	E	K	S	E	R	E	T

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	E	T	R	I	K	A		A	S	P	A	K
T	R	U	P		T	A	L	E	N	T	I	A
T	R			P	A	N	T	E	R	A	T	
B	E	L		S	A	N	D	O	K	A	N	
B	A	K	U	N	I	N		A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H			
P	I	E	E	N	A	O	D	R	E			
A	C	T	O	N	E	K	E	A	L	M	A	
R	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A		
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P		
E	L	S	A	V	A	L	R	O	N	E		
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E		
M	A	B	U	S	E		H	A	N	E	T	
O	R	E	K	S		B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T		K	A	B	I	R	E	T	P
I	B	A		P	E	R	I	T	O	N	I	T
A	I	K	I	M	B	O	I		R	K		
R	A	S	A		P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	R	A	D	O	M	A		
Y	M	A	R	S	I	A	N	E	T	J		
M	A	J	A		F	O	R	M	A			
H	A	R	A	K	T	R	I	E	R	I	T	
A	S	I	I	R	A	D	A	M	E	S		
S	H	A	M	A	T	A		L	O	T	U	S



*Thënie të mënçura*

- Për të arritur gjetjen e thelbit tonë të vërtetë, duhet që më parë të jetojmë të të shtatë mëkatet.
- Udhëtar, nëse nuk takon një shoqëruar më të mirë ose të ngjashëm me veten, vazhdon i bindur vetëm: nuk bëhet shoqëri me budallain.
- Ashtu si një shkëmb masiv nuk tundet nga era, ashtu edhe të mënçurit nuk lëkunden me fajtime dhe lavdimeve.
- Uji kanalizon burimet, harkëtarët lakojnë shigjetat, marangozët përkulin drurin, të mënçurit vetëbinden.

